

**ROMEO GURAKUQI**

Instituti i Historisë/Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë  
romeo.gurakuqi@asa.edu.al

**ARKITEKTURA E INSTITUCIONEVE SHKENCORE  
NË SHQIPËRINË E VITEVE 1940-1945****Abstrakt:**

*Artikulli jep një pasqyrë të plotë të veprimtarisë shkencore në shumë fusha kërkimore dhe një bazë të dhënash të rëndësishme të burimeve njerëzore të Shqipërisë së viteve 1940-1944. Meqenëse pjesa më e madhe e elitës shkencore të Shqipërisë, përfshirë anëtarët e këtij Instituti, u largua nga vendi me dhunë, ose u ekzekutua, u burgos dhe u internua, lexuesi ka mundësinë të kuptojë fshirjen e plotë të një brezi intelektual dhe qytetar të Shqipërisë, si dhe ndryshimin e elitave që “lulëzuan” në mënyrë dramatike në vend pas 29 nëntorit 1944. Duke krahasuar brezin që autori po u jep lexuesve dhe atë që vjen më pas, mund të kuptohet rënia e gjithanshme e veprimtarisë arsimore, shkencore dhe botuese në vend në periudhën në vijim të pasluftës deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë.*

**Fjalë kyçe:**

Instituti i Studimeve Shqiptare, Fondata “Skanderbeg”, elita, veprimtari shkencore, Lufta e Ftohtë.

Qendra e Studimeve për Shqipërinë në Romë, Instituti i Studimeve Shqiptare në Tiranë, Fondata “Skanderbeg”, “Dante Aligheri” Albania, Rrethi italo-shqiptar “Skanderbeg”, Kuvendi i Studimeve Shqiptare, Shqipëria nën Perandorinë fashiste të Romës, “Opera Omnia” Gjergj Fishta, “Opera Omnia” Naim Frashëri, Instituti Shqiptar për Studime dhe Arte, Skedari i Gjuhës Shqipe.

### **Fondata “Skanderbeg”- (Instituti i Studimeve Shqiptare - Rrethi italo-shqiptar “Skanderbeg”)**

Një nga ngjarjet më të rëndësishme në jetën shkencore në Shqipëri pas stabilizimit të pushtimit, gjatë vitit 1940, ka qenë themelimi i "Fondacionit Skanderbeg", i përbërë nga dy seksione: Instituti i Studimeve Shqiptare dhe Rrethi italo-shqiptar “Skanderbeg”.<sup>1</sup> Fondata dhe seksionet përbërëse mund të konsiderohen si pjesë e “arkitekturës institucionale” shkencore dhe kulturore që italianët krijuan në Shqipëri, në mbështetje të politikës së tyre të lejimit të zhvillimit të patriotizmit ideal tradicional dhe nxitjes së studimeve albanologjike për të kamufluar politikat ekspansioniste, por që u shfrytëzua maksimalisht nga njerëzit e kulturës shqiptare, për t’i dhënë një nxitje të mëtejshme, sa mundeshin, pa veshje fashiste, studimeve shkencore, të arsimit e kulturës shqiptare dhe promovimit të jetës intelektuale. Duhet të kujtojmë se aktiviteti shkencor, botues, studiues që ndërmoi ky institucion, ka qenë ndër më të rëndësishmit dhe me një impakt shumë të madh e themelvënës për arsimin, shkencën shqiptare, standardizimin e terminologjisë në administratë, programimin e formimit të nxënësve, krijimin e korpusit të dokumentacionit për Ministrinë e Jashtme shqiptare për çdo konferencë paqeje të pasluftës.

**Kuvendi i studiuesve të filologjisë dhe historisë së Shqipërisë** u mblodh në Tiranë, nga data 9 deri më 12 prill të vitit 1940. Në Kuvendin e Studimeve Shqiptare morën pjesë prof. Matteo Bartoli i Universitetit të Torinos; prof. Sergio Bettini i Universitetit të Padovas; Angelino Corrias i Nën-Sekretariatit të Çështjeve Shqiptare në MPJ në Romë; prof. Igino Epicoco i Misionit Arkeologjik të Butrintit; Francesco Ercole i Akademisë së Italisë në Romë; Amedeo Giannini i Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane; prof. Angelo Leotti nga Bolonja; dr. Lorusso Attoma, Drejtoria e Shtypit dhe Propagandës Tiranë; prof. Gentilio Montanelli, Inspektoriati Qendror i Ministrisë së Arsimit Kombëtar në Romë; prof. Gennaro Maria Monti, i Institutit të Epërm Detar në Napoli; prof. Mario

<sup>1</sup> *Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri, Roma* (më tej: *ASDMAE*), Serie Gabinetto Albania (1938-1945) (më tej: *GA*), busta 195, Ministria e Punëve të Jashtme, Sottosegretariato Affari Albanesi (S.S.A.A.) Shënime, Romë, 21 korrik 1940.

Morandi, këshilltar i Përhershëm i Ministrisë së Arsimit në Tiranë; prof. Domenico Mustilli i Universitetit të Napolit; doc. Paolo Emilio Pavolini i Akademisë së Italisë në Romë; prof. Papas Gaetano Petrotta, i Universitetit të Palermos; dr. Giuseppe Schiro, kryeredaktor i revistës “D’Albania” që botohej në Romë; dr. Carlo Alberto Straneo; prof. Carlo Tagliavini i Universitetit të Padovas dhe Át Zef Valentini jezuit italian i natyralizuar shqiptar, që jetonte në Shkodër. Nga studiuesit vendës kanë marrë pjesë: prof. Frano Alkaj nga Fushë Kuqja (punonte në Korçë asokohe), Ali Asllani (Tiranë), Dhimitër Berati (Romë), prof. Eqrem Çabej (Tiranë), Nebil Çika (Tiranë), Át Gjergj Fishta (Shkodër), prof. Filip Fishta (Tiranë), Mid’hat Frashëri (Tiranë), Stavro Frashëri (Durrës), prof. Karl Gurakuqi (Tiranë), Tonin Guraziu (Tiranë), Át Anton Harapi (Shkodër), Et’hem Haxhiademi (Tiranë), Kolë Kamsi (Tiranë), Sotir Kolea (Elbasan), Vangjel Koça (Tiranë), Ernest Koliqi (Tiranë), Dom Mikel Koliqi (Shkodër), senator Mustafa Kruja (Tiranë), Át Donat Kurti (Shkodër), prof. Mati Logoreci (Tiranë), Vangjush Miho (Korçë), Anastas Mio (Korçë), Ludovik Naraçi (Tiranë), Lef Nosi (Elbasan), Át Benardin Palaj (Shkodër), prof. Ndue Paluca - Tiranë (nga Kosova), Papas Josif Papamihali (Berat), prof. Thoma Papapano (Gjirokastër), Odhise Paskali (Tiranë), prof. Petraq Peppo (Elbasan), dr. Rosolino Petrotta (Tiranë), prof. Lasgush Poradeci (Tiranë), Vinçens Prennushi (Shkodër), Ilo Mitko Qafëzezi (Korçë), prof. Namik Resuli (Tiranë), Imzot Paolo Schiro, Piana dei Greci, Át Marin Sirdani (Shkodër), Dom Lazër Shantoja (Tiranë), Terenc Toçi Tiranë, Ekrem Vlora (Vlorë), Hasan Xega (Tiranë), prof. Aleksandër Xhuvani (Tiranë).

Në presidiumin e punimeve kanë qenë ulur senatori Mustafa Kruja, ministri Ernest Koliqi, Ercole, Tagliavini dhe si sekretarë kanë qenë prof. Eqrem Çabej e Namik Resuli. Në këtë mbledhje u trajtuan dy pikat e para të rendit të ditës. Prof. Tagliavini bëri një ekspozicion të shkurtër të studimeve mbi gjuhën shqipe: gjendjen aktuale, veprat në vijim dhe projektet e punës, duke vendosur në evidencë, atë çfarë ishte arritur deri atëherë, si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë saj. Theksi u vendos në kontributin e veçantë që kishin dhënë studiuesit italianë. Tagliavini, gjithashtu, vuri në dukje nevojën absolute për përpunimin e një fjalori të madh të gjuhës shqipe, që të përfshinte plotësisht tekstet letrare dhe folklorin. Për të diskutuar mbi relacionin e Tagliavini-t, e morën fjalën më pas fjalën prof. Çabej dhe Át Valentini. Më pas, prof. Bartoli

lexoi një promemorie në të cilën ai tregoi se që në vitin 1927 kishte ndërmarrë një projekt të përpunimit të një atlasit gjuhësor të shqipes, dhe i bëri ftesë kongresit të bëhej promotor i realizimit të këtij projekti. Ercole njoftoi kongresin se Qendra e Studimeve mbi Shqipërinë pranë Akademisë Mbretërore të Italisë, kishte marrë tashmë një vendim në lidhje me këtë. Senatori Mustafa Kruja lexoi një relacion mbi problemin e njësimimit të gjuhës letrare shqipe. Relacioni u mbajt në gjuhën italiane. Autori kërkoi të bindte auditorin që gjuha e ardhshme letrare shqipe duhej të bazohej mbi dialektin gegë të pjesës më jugore të Gegnisë, çfarë nënkuptonte dialektin e Elbasanit (duke përputhur këtë opinion me vendimin e dikurshëm të Komisionit Letrarez të Shkodrës), pa lënë mënjanë elemente të origjinave të tjera. Kruja shtoi se ishte e vështirë që një gjuhë letrare të formohej për shkak të vullnetit të filologëve dhe gjuhëtarëve të gramatikës. Por për ta bërë të mundshme këtë duhej ndërthurja e një sërë ngjarjesh historike dhe gegnishtja jugore do të bëhej gjuhë letrare për arsye historike dhe gjeografike, kur rrugët e asfaltit që po hapte fashizmi në Shqipëri, do të shkurtonin komunikimin mes Veriut dhe Jugut dhe shkëmbimet e shpeshta të arriheshin midis rajoneve toske dhe gege. Ndërkaq Tirana, sipas Mustafa Krujës, që deri para pak kohësh kishte vetëm 30 000 banorë, tani kishte arritur në 50 000 banorë dhe në të ardhmen jo të largët do të bëhej 100 000. Në Tiranën kryeqytet konvergonin, sipas tij jo pa të drejtë, elementët shqiptarë të Veriut e të Jugut dhe kështu ky qytet do të ishte sahati i gjuhës letrare shqipe. Relacioni dhe kumtesat u ndoqën me shumë interes publik, jo pa refleksione politike, për sa u përket pakicave shqiptare përtej kufijve politikë të Shqipërisë. Në orën 18:30 senatori Kruja mbajti në teatrin “Savoja”, në gjuhën shqipe, një konferencë mbi problemin e unifikimit të gjuhës letrare shqipe, para një publiku të gjerë dhe para autoriteteve që kryesoheshin nga Jakomoni. Ndërsa në orën 20:30, në Rrethin italo-shqiptar “Skanderbeg”, ministri Koliqi shtroi një darkë për pjesëmarrësit. Të nesërmen, më 10 prill 1940, kongresistët shkuan për vizitë në Shkodër, ku u pritën me nderime nga autoritetet bashkiake shkodrane në selinë e bashkisë, vizituan qytetin, kolegjet dhe bibliotekat e Etërve Jezuitë dhe Etërve Françeskanë, Pazarin e Shkodrës. Pasdreke në orën 16:00 kongresistët u mblodhën në Teatrin e Etërve Jezuitë, të mbushur me publik, për të dëgjuar konferencën që mbajti prof. Mustilli, mbi: “Shqipërinë Romake”, të ilustruar me shumë foto. Pas mbërritjes në Tiranë në orën 22, ministri Koliqi shtroi një pritje, në të cilën dy

këngëtarë shqiptarë kënduan këngë popullore, ndërsa një rapsod autentik i maleve shqiptare, këndoi me lahutë një pjesë epike. Më 11 prill udhëtimi i parashikuar me avion për në Korçë, për shkak të motit të keq, nuk u realizua dhe kështu që kongresistët vizituan Krujën, ndërsa në darkë u pritën nga Jakomoni. Më 12 prill në orën 09:00, rifilluan punimet e ndërprera të martën në darkë, me relacionin e prof. Petrotta-s, mbi literaturën italo-shqiptare, për të cilën diskutuan më pas prof. Eqrem Çabej, prof. Karl Gurakuqi dhe Dhimitër Berati. Pasi një relacion i hollësishëm i prof. Mustilli-t mbi studimet arkeologjike shqiptare, në të cilat ai ekspozoi posaçërisht rezultatet e Misionit Arkeologjik Italian në Butrint. Mbi relacionin e prof. Mustili-t morën fjalën prof. Bettini, Peppo, Bartoli, Çabej e të tjerë. Në orën 11:30 Kuvendi vazhdoi me relacionin e At Zef Valentinit mbi studimet historike. Ky relacion shumë i thelluar dhe i dokumentuar, u ndoq me interes të madh nga auditori dhe u pasua me diskutimet e profesorëve Peppo, Bartoli, Ercole etj. Pasdreken e datës 12 prill, në orën 15:00, u shqyrtua pika e fundit e rendit të ditës, që kishte të bënte me përgatitjen e një programi për Kongresin e Studimeve Shqiptare, që do të mbahej në Napoli, nga fundi i gushtit apo fillimi i muajit shtator të vitit 1940. Më pas iu delegua Institutit të Studimeve Shqiptare, themelimi i të cilit u njoftua se do të bëhej më vonë, përpunimi i një plani të detajuar të kongresit të ardhshëm dhe marrja e vendimit mbi listën e personave që do të ftoheshin për të përgatitur relacionet. Në fund, në orën 17:00, kongresistët u mbledhën në sallën e Mëkëmbësisë së Përgjithshme për të asistuar në inaugurimin solemn të Institutit të Studimeve Shqiptare dhe themelimit të Fondacionit “Skanderbeg”, të shpallur nga Jakomoni.<sup>2</sup>

Dekretet e Mëkëmbësisë së Përgjithshme për themelimin e Fondacionit “Skanderbeg” dhe shpalljen e Statutit të Institutit të Studimeve Shqiptare, mbajnë datën 8 prill të vitit 1940 dhe kanë numrat

<sup>2</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) Mëkëmbësia e Përgjithshme, Viti (më tej: V.), 1940, Dosja (më tej: D.) 310. Relacion i prof. Tagliavini-t për Jakomonin.

Po ashtu, punimet e plota të Kuvendit gjenden në botimin: *Mâ i Pari Kuvend i Studimevet Shqiptare – Il Primo Convegno di Studi Albanesi, Tirana, 9-12 Aprile 1940-XVIII*, botim i Institutit të Studimevet Shqiptare i Themelatës “Skanderbeg” (Roma: 1940).

e vendimit gjegjësisht 140 dhe 141.<sup>3</sup> Ndër emërimet që i janë bashkëngjitur Institutit të Studimeve Shqiptare në Tiranë janë: dekreti i ministrit Koliqi për emërimin në këtë institucion të Aleksandër S. Drenovës, poet (Bukuresht); Xhevat Korçës, historian (Tiranë); Át Justin Rrotës, linguist, letrar (Shkodër), Et'hem Haxhiademit, dramaturg (Tiranë).<sup>4</sup> Ndërsa lista e plotë e anëtarësisë na bëhet me dije nga një shkresë e Jakomonit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, më 20 prill 1940. Sipas kësaj shkrese, kuptojmë se aktivitetet e Fondacionit “Skanderbeg” dhe Institutit të Studimeve Shqiptare do të ishin ngushtësisht të kontrolluara nga Mëkëmbësia e Përgjithshme dhe do të koordinoheshin plotësisht me Akademinë Mbretërore në Romë. Me dekret të Mëkëmbësisë së Përgjithshme në Tiranë, anëtarë të Institutit të Studimeve Shqiptare u emëruan: italianë: prof. Antonio Baldacci - gjeograf, etnograf, botanist (Bolonjë); prof. Matteo Bartoli, linguist (Torino); prof. Sergio Bettini, historian arti (Padova); Át Nilo Borgia, historian dhe letrar (Grottaferrata); Át Fulvio Cordignano, historian dhe gjuhëtar (Shkodër); prof. Francesco Ercole, historian (Romë); prof. Angelo Leotti, ekspert i gjuhës shqipe (Bolonjë); dr. Nicola Lorusso Atoma, ekspert i studimeve historike (Tiranë); prof. Genaro Maria Monti, historian (Napoli); prof. Domenico Mustilli, arkeolog (Napoli); Paolo Emilio Pavolini, filolog (Romë); prof. Papas Gaetano Petrotta, filolog, letrar (Palermo); dr. Giuseppe Schiro, filolog (Romë); prof. Carlo Tagliavini, linguist (Padova); Át Giuseppe Valentini, historian dhe letrar (Shkodër). Personalitetet shqiptare të emëruar ishin: Dhimitër Berati, ekspert i studimeve historike (Korçë); prof. Eqrem Çabej, gjuhëtar (Tiranë); Át Gjergj Fishta, poet (Shkodër); prof. Karl Gurakuqi, gjuhëtar dhe letrar (Tiranë); Át Anton Harapi, letrar (Shkodër); prof. Kolë Kamsi, gjuhëtar dhe historian (Tiranë); dr. Vangjel Koço (Tiranë); Ernest Koliqi, poet dhe letrar (Tiranë); senator Mustafa Kruja, linguist dhe letrar (Tiranë); prof. Mati Logoreci, letrar (Tiranë); Át Benardin Palaj, folklorist; prof. Ndue Paluca; dr. Ilo Mitko Qafëzezi, historian (Korçë); prof. Namik Resuli, linguist (Tiranë); Dom Lazër Shantoja, poet dhe letrar (Tiranë); prof. Aleksandër Xhuvani, linguist dhe letrar (Tiranë); dr. Eqrem Bej Vlora, historian dhe gjeograf (Vlorë). Me të njëjtin dekret,

<sup>3</sup> *AQSH*, F. Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1940, D. 310. Shkresë e Ministrisë së Arsimit, 26 gusht 1940.

<sup>4</sup> *Po aty*, F. Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1940, D. 315. Shkresë nr. 2199 e ministrit Ernest Koliqi drejtuar Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Tiranë, 23 maj 1940.

President i Institutit u emërua prof. senator Mustafa Kruja, zëvendës-president prof. Tagliavini.<sup>5</sup>

Këshilli Shkencor i Institutit të Studimeve Shqiptare si një nga dy seksionet e Fondatës “Skanderbeg” do të përbëhej nga kryetar senator Mustafa Kruja, nënkryetar prof. Carlo Tagliavini, këshilltarë: prof. Eqrem Çabej, At Zef Valentini, Dom Lazër Shantoja, prof. Aleksandër Xhuvani.<sup>6</sup>

Fondata “Skandërbeg”, si kupola qeverisëse e dy njësive, drejtohej nga një Këshill i Administrimit, i emëruar me dekretin e Mëkëmbësisë së Përgjithshme të datës 18 prill 1940 dhe në përbërje të tij kanë qenë: Lombardi, Radici, Pema. Senatori Mustafa Kruja kërkoi që fondi mbështetës i Fondacionit “Skanderbeg” dhe i Institutit të Studimeve Shqiptare të ishte i rëndësishëm dhe parashikimet që ai jepte ishin shumë më tepër, sesa donacionet që Musolini kishte dhënë për Akademinë e Italisë.<sup>7</sup> Kontributi që Jakomoni vendosi të jepte fillimisht për Fondacionin “Skanderbeg” në një vit ka qenë 100 000 lira.<sup>8</sup> Nga dekreti i Mëkëmbësit të Përgjithshëm mbi “Normat e Përgjithshme mbi Administrimin e Fondatës Skanderbeg si edhe atributat e posaçme të Këshillit Administrativ”, kuptojmë që Fondacioni “Skanderbeg” përbëhej nga pasuria e dhënë në kapital prej themeluesit, që ishte Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë, si dhe prej hyrjeve e donacioneve. Kapitali i dhënë ishte 8 000 000 lira, prej të cilave 6 000 000 u investuan në dy ndërtesa dhe 2 000 000 lira që do të investoheshin në jetën e Institutit të Studimeve Shqiptare. Fondacioni “Skanderbeg” do të mbikëqyrte administrimin e Institutit të Studimeve Shqiptare.<sup>9</sup>

Rreth Institutit të Studimeve Shqiptare në Tiranë u mbledh e gjithë elita intelektuale e letrave shqipe. Në qoftë se vihet re me kujdes, pjesa më e madhe e kësaj elite, ose do të eliminohet fizikisht pas 4 vjetësh, ose

---

<sup>5</sup> ASDMAE, GA, busta 160, Jacomoni drejtuar Ministrisë Mbretërore të Punëve të Jashtme, Tiranë, 20 prill 1940, telesspresso nr.12195/3551.

<sup>6</sup> *Mâ i Pari Kuvend i Studimevet Shqiptare ...*, 50.

<sup>7</sup> AQSH, F. Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1940, D. 315. Shënime për Shkëlqesinë Parini.

<sup>8</sup> *Po aty*, F. Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1940, D. 315. Telegram nr. 928, Jacomoni drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtoria e Çështjeve Private, 28 shtator 1940.

<sup>9</sup> *Po aty*, F. Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1940, D. 315. Normat e përgjithshme mbi administrimin e Fondatës “Skanderbeg” si edhe atributat e posaçme të Këshillit Administrativ.

do të detyrohet të largohet nga vendi dhe veç shumë pak nga ata, mundën të mbijetonin në vetminë e tyre intelektuale brenda territorit të shtetit shqiptar pas ardhjes së komunistëve në pushtet. Për të kuptuar se çfarë përfaqësonin disa prej tyre, që u eliminuan fizikisht me ardhjen e komunistëve në krye të punëve shtetërore në fund të vitit 1944, unë do të dëshiroja të paraqitja disa prej biografive të studiuesve dhe bashkëpunëtorëve shkencorë të Institutit, ashtu sikurse janë përpiluar nga kjo qendër studimore, me rastin e shqyrtimit të mundësisë së përgatitjes së një Antologjie të Letërsisë Shqipe në gjuhën italiane.<sup>10</sup>

Gjatë kohës së Luftës Italo-Greke, Instituti, që ndodhej në fillimet e veprimtarisë së vet, pësoi një pushim në jetën e brendshme. Selia e këtij institucioni u zu për nevoja të Ushtrisë Mbretërore Italiane dhe u mbajt edhe për disa kohë pas përfundimit të luftës. Megjithatë, puna nuk u ndërpre dhe secili anëtar e zhvilloi punën e ngarkuar individualisht. Bazuar në punën e pavarur të anëtarëve të institucionit, Instituti kreu vepra të konsiderueshme, si për shembull, përpilimin e 300 000 skedave për fjalorin e gjuhës shqipe që janë vjelë nga të gjithë fjalorët ekzistues të botuar ose jo, si dhe studime në fushën e Folklorit. Nevojat e enteve të ndryshme në lidhje me terminologjinë që do të duhej të përdornin në komunikimin zyrtar dhe publik, i kushtëzuan Institutit, themelimin e një Komisioni të Posaçëm për Terminologjinë. Bëhej fjalë për një komision që do të formalizonte terminologjinë, që ende prodhonte studimi i neologjizmave të natyrës popullore, për të nxjerrë rregullat që do të duhej të drejtonin komisionin në formimin e neologjizmave, konform rregullave të gjuhës shqipe. Për të korrigjuar anarkinë që mbizotëronte në lidhje me toponomastikën shqiptare, Instituti ndërtoi një komision, i cili në një moment të parë vendosi rregullat e nevojshme të përgjithshme dhe në vijim depozitoi pranë Zyrës Qendrore të Statistikave, që gjendej në Këshillin e Ministrave, “Listën e Toponimeve: që i shërbenin këtij institucioni për përpilimin e “Hartës së Provincave dhe Komunave të Mbretërisë”. Një punë e ngjashme u zhvillua për hartimin e listës për toponomastikën urbane të kryeqytetit. Për të promovuar njohjen e letërsisë shqiptare edhe jashtë, veçanërisht në Itali, u krijua një komision për përzgjedhjen e teksteve të letërsisë popullore tanimë të përkthyer, në mënyrë që në fund të vitit akademik 1942-43, të mund të botohej vëllimi i parë. Po ashtu u bë gati germa “A” e Fjalorit të madh të senatorit Kruja;

<sup>10</sup> *Po aty*, F. Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1940, D. 309.

seria e Parë e Studimeve Juridike të Koliqit, Valentinit, Palajt mbi Kanunin; një vëllim tjetër i Valentinit mbi organizimin shoqëror të shqiptarëve si dhe një “Corpus” prej 289 dokumentesh, kryesisht të panjohura, që ilustronin traditën juridike të veçantë të vendit përgjatë shekujve. Ndër veprat e tjera të përgatitura për botim ishin edhe Koleksioni i Studimeve Gjuhësore të Mustafa Krujës dhe Studimet Psikologjike mbi mentalitetin e malësorëve, i redaktuar prej Át Anton Harapit.<sup>11</sup>

Nga tetori i vitit 1941 deri në gusht të vitit 1942, kryetari i parë Merlika Kruja dhe më pas kryetari i dytë, Ernest Koliqi, të emëruar me Dekrete Mëkëmbësore, Komisarë Mëkëmbësorë të Fondatës “Skanderbeg” dhe të Rrethit italo-shqiptar “Skanderbeg”, të ndihmuar prej një grupi ekspertësh, u morën me riorganizimin e këtyre enteve. Ernest Koliqi, i mbështetur në këshillat e ekspertëve, i paraqiti qeverisë mbretërore disa ndryshime të nevojshme që i duheshin bërë Statutit të Institutit të Studimeve Shqiptare.<sup>12</sup>

Kështu gradualisht, në vjeshtën e vitit 1942, fillon periudha e dytë e jetës administrative dhe shkencore të Institutit të Studimeve Shqiptare. Rregullimi i ri juridik i Institutit të Studimeve Shqiptare dhe Fondacionit “Skanderbeg”, është realizuar me Dekretin Mëkëmbësor nr. 221, datë 10 gusht 1942,<sup>13</sup> dalë në Fletoren Zyrtare të Mbretnisë Shqiptare, më 21 shtator 1942,<sup>14</sup> aprovuar në Këshillin e Epërm Fashist Korporativ, në mbledhjen e datës 3 mars 1943, në kohën e qeverisjes së Kryeministrit Maliq Bushati. Ernest Koliqi, në fjalimin e tij në organin legjislativ të kohës, e konsideroi këtë rregullim të gjendjes juridike të këtij institucioni, si guri i parë i ndërtimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.<sup>15</sup> Me dekretin e lartpërmendur Instituti do të quhej tanimë, “**Instituti**

<sup>11</sup> *Po aty*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19; “Institutit i Studimeve Shqiptare dhe misioni i tij i lartë”, gazeta *Tomori*, Tiranë, e mërkurë 30 shtator 1942.

<sup>12</sup> *AQSH*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Shkresë e Institutit Mbretëruar të Studimeve Shqiptare, Tiranë, më 9.10.1942, nr. prot. 40.

<sup>13</sup> *Po aty*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Dekret i Këshillit të Naltë, caktimi i fizionomisë juridike të Institutit të Studimeve Shqiptare; gazeta *Tomori*, Tiranë, 2 shtator 1942, viti XX. Aprovimi i Statutit të ri të Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare.

<sup>14</sup> *AQSH*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Fletorja Zyrtare e Mbretnisë Shqiptare, Tiranë, e hanë, 21 Shtatuer 1942- XIX.

<sup>15</sup> *Gazeta Tomori*, Tiranë, 4 mars 1943, Viti XXI. U pranua me duartrokitje D.M. mbi Institutin e Studimeve Shqiptare.

**Mbretëror i Studimeve Shqiptare**” dhe do të kishte si mision promovimin dhe bashkërendimin e jetës intelektuale shqiptare në fushën e shkencës, të letërsisë dhe artit dhe **përbënte analogun shqiptar të Akademisë Mbretërore të Italisë**. Përndryshe, Rrethi italo-shqiptar “Skanderbeg” me seli në Tiranë, ishte krijuar me synimin për t’i bërë më të afërta marrëdhëniet shoqërore në mes shqiptarëve dhe italianëve. MPJ e Italisë, që me themelimin e Fondacionit “Skanderbeg” në vitin 1940, kishte akorduar për atë një fond ministerial prej 2 milionë liretash, për 20 vjet, ndarë në 100 000 lireta për vit, baras me 5% të fondit total.<sup>16</sup> Në bazë të statutit të ndryshuar, Instituti Mbretëror i Studimeve Shqiptare kishte për qëllim të nxiste e të bashkërendonte lëvizjen intelektuale shqiptare në fushën e shkencave, të letrave dhe të arteve; të kujdesohej për pasurimin e kulturës kombëtare, duke marrë si shembull kombet europiane më të mësuara, por njëkohësisht duke ruajtur karakterin e thjeshtë kombëtar, sipas mendësisë dhe traditave më të mira të fisit arbëror. Instituti u mvesh me personalitet juridik dhe me mëvehtësi administratore, nën mbrojtjen e shtetit, të ushtruar prej Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Anëtarët e rendëshëm të Institutit ishin 48 personalitetet dhe emëroheshin me Dekret Mekëmbësor, mbi bazën e propozimit të kryeministrit, mbasi dëgjohej më parë Këshilli i Ministrave. Për çdo vend vakant, Instituti zgjidhte tre vetë, të cilët i parashtronte për emërim. Emërimi më pas bëhej nëpërmjet personave të zgjedhur prej Institutit dhe ishte i përjetshëm. Kryetari i Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare, në rendin e pritjeve zyrtare dhe në funksionet publike, zinte vend përpara ministrave të shtetit, ndërsa anëtarët e rendëshëm të Institutit zinin vend para anëtarëve të Parlamentit (Këshillit të Epërm Fashist Korporativ). Si kryetari ashtu edhe anëtarët e Institutit Mbretëror gëzonin nderimet, titujt, privilegjet dhe dinjitetin e përcaktuar për ministrat e shtetit dhe për parlamentarët. Anëtarë të rendëshëm të Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare në vitin 1942, pas largimit në postin e kryeministrit të kryetarit të parë të këtij institucioni, ishin si vijon: kryetar Ernest Koliqi, anëtarë: Mustafa Merlika-Kruja, Dhimitër Berati, Eqrem Çabej, Karl Gurakuqi, Anton Harapi, Kolë Kamsi, Vangjel Koça, Benardin Palaj, Lasgush Poradeci, Ilo Mitkë Qafzezi, Namik Resuli, Lazër Shantoja, Ekrem Vlora, Aleksandër Xhuvani, Ndue Paluca, Antonio Baldacci, Matteo

<sup>16</sup> ASDMAE, GA, busta 195, Shënime, Romë, 20 shkurt 1943.

Bartoli, Sergio Bettini, Fulvio Cordignano, Francesco Ercole, Nicola Lo Russo Attoma, Gennaro Maria Monti, Domenico Mustilli, Paolo Emilio Pavolini, Gaetano Petrotta, Giuseppe Schirò, Carlo Tagliavini, Zef Valentini.<sup>17</sup> Ceremonia e betimit të anëtarëve dhe përrurimi i vitit akademik 1942-43 u zhvillua më 16 nëntor 1942 në selinë e këtij Instituti, në prani të Mëkëmbësit të Mbretit Jakomoni.<sup>18</sup> Instituti ka qenë i ndarë në katër komisione: 1. Komisioni i Shkencave Morale e Historike; 2. Komisioni i Shkencave Fizike, Matematike e Natyrore; 3. Komisioni i Letërsisë; 4. Komisioni i Arteve.<sup>19</sup> Për Komisionin e Gjuhës dhe të Letërsisë u zgjodhën anëtarët e poshtëshënuar sipas nën/komisioneve: 1. N/Komisioni i Gjuhësisë: Bartoli, Borgia, Çabej, Resuli, Schirò, Tagliavini dhe Xhuvani; 2. N/Komisioni i Orthografisë dhe i Gramatikës me anëtarë: Berati, Çabej, Gurakuqi, Kruja, Paluca, Xhuvani, Rrota; 3. N/Komisioni i Terminologjisë me anëtarë: Çabej, Gurakuqi, Kruja, Resuli, Tagliavini, Xhuvani; Paluca, Kamsi, Valentini, Koça, Koliqi, Poradeci, Shantoja, Rrota, Haxhiademi. 4. N/Komisioni i Fjalorit prej anëtarëve: Berati, Cordignano, Çabej, Gurakuqi, Kamsi, Kruja, Leotti, Petrotta, Resuli, Tagliavini, Valentini dhe Xhuvani; 5. N/Komisioni i Letërsisë me anëtarë: Cordignano, Fishta, Harapi, Koça, Koliqi, Palaj, Pavolini, Petrotta, Shantoja dhe Valentini; Korça, Haxhiademi, Drenova, Rrota. 6. N/Komisioni i Folklorit me anëtarë: Çabej, Cordignano, Fishta, Harapi, Kamsi, Koliqi, Palaj Pavolini, Poradeci, Shantoja, Valentini, Korça. Për Komisionin e Historisë dhe Gjeografisë u caktuan këta anëtarë: Baldacci, Berati, Borgia, Cordignano, Ercole, Kamsi, Monti, Mustilli, Paluca, Petrotta, Qafëzezi, Valentini, Vlora, Shantoja, Valentini

<sup>17</sup> *Gazeta Tomori*, Tiranë, 2 shtator 1942, viti XX. Aprovimi i Statutit të ri të Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare.

<sup>18</sup> *AQSH*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Shkresë e Ernest Koliqit drejtuar anëtarëve të kabinetit qeveritar, të Dhomës etj.: Mirakaj, Shuk Gurakuqi, Toçi, Kotte, Agushi, Toro, Leka, Vërlaci, Gjonmarkaj, Bushati, Alizoti, Beça, Mborja, Koculi, Dalmazzo, Sherif Langu, Kisi, Riza, Lugini, Mulleti, D. Shtjefën Kurti, Fortuzi, Minarolli, Hasan Dosti, Montanelli, Meloni, Nonis, Berardi, Çoba, Petrocchi, më 15.11. 1942, Prot. nr. 63/4; *Gazeta Tomori*, 15 nëntor 1942, viti XX. Në Institutin Mbretëror të Studimeve Shqiptare, ceremonia e betimit të anëtarëve dhe përrurimi i vitit akademik në prani të Mëkëmbësit të Mbretit.

<sup>19</sup> “Institutit i Studimeve Shqiptare dhe misioni i tij i lartë”, *gazeta Tomori*, Tiranë, e mërkurë 30 shtator 1942.

dhe Vlora.<sup>20</sup> Në Komisionin e Shkencave Matematike, Fizike dhe Natyrore u emëruan: Nikolla Lako, i mirënjohur si studiues i botanikës e veçanërisht si gjurmues i kujdesshëm i botanikës shqiptare; prof. Michele Parrino, kompetent në fushën e Mineralogjisë. Në Degën e Shkencave Historike dhe Morale, prof. M. Milone, vepra e të cilit ishte randësiplotë në fushën e studimit të ekonomisë së Shqipërisë. Në Degën e Arteve: A. Lorenzo Tardo, i specializuar në fushën e studimeve bizantine dhe dr. Odhise Paskali, skulptor i njohur për vepra monumentale.<sup>21</sup>

Kështu, faza e dytë e veprimtarisë së Institutit ka filluar më 21 shtator 1942, me mbledhjen e të gjithë anëtarëve që ndodheshin në Tiranë, nën kryesinë e Ernest Koliqit, me pjesëmarrjen e Mustafa Merlika-Krujës, Xhevat Korçës, Dhimitër Beratit, Ekrem Vlorës, Karl Gurakuqit, Vangjel Koçës, Dom Lazër Shantosë, Aleksandër Xhuvanit, Ndue Palucës, Et'hem Haxhiademit, Nicola Lo Russo Attomas, Át Zef Valentinit dhe Át Anton Harapit. Mbledhja vendosi që të mbetej në fuqi këshilli i mëparshëm i emëruar me Dekretin Mbretëror të 12 prillit 1940. Më 28 shtator 1942, kryetari i ri i Institutit, Ernest Koliqi u betua në një ceremoni solemne para Mëkëmbësit të Mbretit-Perandor, në prani të kryeministrit, ministrave të Arsimit dhe të Kulturës, funksionarëve të lartë civilë e ushtarakë.<sup>22</sup>

Programi i veprimtarisë punuese për vitin akademik 1942-1943 përmblihte tri vija të mëdha kryesore: kuvende shkencore, artistike, letrare, historike. Instituti do të përfundonte Skedarin e Madh Bibliografik të Arsyetuar rreth Shqipërisë; një studim të posaçëm që po kryhej për onomastikën dhe toponomastikën e Shqipërisë; Fjalorin për nevojat shkollore në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, që do të ndiqte gjurmët e fjalorit të përgatitur nga Mustafa Merlika-Kruja; Fjalorin e Madh me 300 000 skeda, si vepër monumentale e gjuhësisë shqiptare.

<sup>20</sup> *AQSH*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Shkresë e Institutit Mbretënor të Studimeve Shqiptare, Tiranë, më 9.10.1942, nr. prot. 40.

<sup>21</sup> *Po aty*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Shkresë e Institutit Mbretënor të Studimeve Shqiptare, Tiranë, më 21.11.1942, nr. prot. 44/3, nga Át Zef Valentini.

<sup>22</sup> *Po aty*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Shkresë e Institutit Mbretënor të Studimeve Shqiptare, Tiranë, më 9.10.1942, nr. prot. 40.

Parashikohej gjithashtu edhe botimi i veprave themelore të Naim Frashërit dhe të Át Gjergj Fishtës.<sup>23</sup>

Po në këtë kohë me Dekret Mekëmbësor u aprovua edhe Statuti i ri i Rrethit italo-shqiptar “Skanderbeg”, degë e Fondatës “Skanderbeg”, institucion i ngritur me qëllimin e “përkrahjes dhe mbajtjes së marrëdhënieve sa më të ngushta mes italianëve dhe shqiptarëve, përmes shfaqjeve shoqnore, kulturore, argtimore”.<sup>24</sup>

Më 12 dhjetor 1942, Këshilli i Institutit Mbretnor të Studimeve Shqiptare i mbledhur nën kryesinë e kryetarit Koliqi dhe anëtarëve të Këshillit Akademik, Xhuvani, Shantoja, Valentini dhe disa anëtarëve të ftuar për të dhënë mendim, vendosi për të pranuar si anëtarë të Institutit dhe të propozojë për dekretim mëkambësor edhe këta anëtarë të rinj: 1. Për Komisionin e Shkencave Morale dhe Historike: Hasan Dosti, Kolë Dhimitri, Emin Toro. 2. Për Komisionin e Shkencave Fizike, Matematike dhe Natyrore: Nikolla Lako, Ilija Mitrushu Panariti dhe prof. Lorenzoni. 3. Për Komisionin e Letërsisë: Imzot Vinçenc Prennushi (propozuar nga prof. Kolë Kamsi), Át Mark Harapi (propozuar nga Dom Lazër Shantoja), Kristo Floqi, Sotir Kolea, Ali Asllani, Dom Ndre Zadeja. Për Degën e Arteve: Odhise Paskali, Kristo Kono, Át Lorenzo Tardo.<sup>25</sup> Mbledhjet e përgjithshme të Misave të Rendëshëm të Institutit u përcaktuan të bëheshin dy herë në vit, më 23 prill dhe 28 nëntor, ndërsa mbledhjet e Komisionit të Gjuhës të mbaheshin 8 herë në muaj; mbledhjet e Këshillit Shkencor të Institutit 4 herë në muaj çdo ditë të hënë etj., etj.<sup>26</sup>

<sup>23</sup> Gazeta *Tomori*, Tiranë, e enjte, 1 tetor 1942. Program i gjerë i punimeve të Institutit Mbretnor të Studimeve Shqipëtare; ASDMAE, GA, busta 195, “L’Istituto di Studi Albanesi a Tirana e il suo vasto programma di lavoro”. Letër e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar Giuseppe Schiro-it (Centro di Studi per l’Albania, presso la Reale Accademia d’Italia, 22 ottobre 1942).

<sup>24</sup> Gazeta *Tomori*, Tiranë, 16 mars 1943, Viti XXI, Statuti i ri i Rrethit “Skanderbeg”.

<sup>25</sup> AQSH, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Shkresë e Ernest Koliqit drejtuar Kryeministrit Mustafa Merlika - Kruja, Tiranë, 21 dhjetor 1942.

<sup>26</sup> *Po aty*, F. 200/Institutit i Studimeve Shqiptare, V. 1942, D. 19. Mbledhjet e Përgjithshme të Misavet të Rendëshëm.

## Veprimtaria e Institutit të Studimeve Shqiptare në Tiranë gjatë vitit akademik 1942-1943

Pas formalizimit të kuadrit ligjor të Institutit, në gjirin e tij u krijuan: një komision i veçantë për caktimin e toponomastikës shqipe të “Tokave të Lirume”, të kryesuar prej prof. Aleksandër Xhuvanit; një zyrë e cila do të merrej me përgatitjen e Muzeut shqiptar të Shkencave Natyrore nën drejtimin e profesoreshës Sabiha Kasimati. Po ashtu, Instituti bleu një koleksion kostumesh kombëtare të trevave të ndryshme të Kosovës dhe një koleksion prej afro 400 monedhash të moçme për pasurimin e Koleksionit Numizmatik Shqiptar. Komisioni i Terminologjisë arriti të shqyrtojë deri te germa “H” fjalorët kryesorë të shqipes, për të nxjerrë rregullat që drejtonin trajtimin e fjalëve të reja sipas natyrës së thjeshtë të gjuhës shqipe. Brenda Institutit Mbretnor ekzistonin dy komisione të ngarkuara për botimin e “Opera Omnia” (veprave të plota) të Át Gjergj Fishtës<sup>27</sup> dhe Naim Frashërit,<sup>28</sup> të cilat vijonin punën e tyre edhe për

<sup>27</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1942, D. 37. “Mbi Botimin e “Opera Omnia” të ndjerit Át Gjergj Fishta” 10.10.1942 dhe “Plani i botimit të Opera Omnia të Át Gjergj Fishtës, Shkodër, 21.12.1942”. Anëtarët e Këshillit të Institutit, përmes Ernest Koliqit, i kërkuar bashkërrëgjulltarëve të poetit, përgatitjen e planit dhe të veprimit për botimin e “Opera Omnia” të Át Gjergj Fishtës. Në këtë komision, përveç Át Anton Harapit, u ngarkuan edhe Át Viktor Volaj, Át Benedikt Dema dhe Át Jak Marlekaj. Ky plan veprimi do të duhej t’i përgjigjej këtij kuestjonari: “1) A ju duket mirë të botohen të gjitha veprat e tija, edhe ma të voglat sikur për shembull, artikujt e letrat e botueshme? 2) A ju duket mirë të botohen të gjitha pa dallim në rend kronologjik për ta pa ma mirë zhvillimin menduer edhe stilistik t’auktorit? 3) A ju duket ma mirë të dallohen në volume të veçanta, p.sh. a) veprat e mëdhaja e veprat e vogla; 2) veprat poetike e veprat prozaike; 3) në rasë qi pranohet hipoteza b, a, ju duket mirë të dallohen veprat mbas sojevet të ndryshme letrare, sikurse veprat epike, dramatike e lirike? 4) Tue pasë një interesë gjuhësorë edhe letrarë krahasimi i definicionevet të ndryshme, si ju duket mirë praktikisht se mund të plotësohet ky qëllim? 5) Me çë masë e me çë method ju duket se mund të bahet komentimi i domosdoshëm?... Kryetari, Ernest Koliqi, Tiranë, 10.10.1942”. Pas dy muajsh, plani u propozua në emër të Komisionit nga Provinciali i Françeskanvet, Patër Anton Harapi. Ai i shkruan drejtuesve të Institutit: “Në gjegje të letrës së Juej grupi që do të kurojë botimin e “Opera Omnia” të A. Gjergj Fishta asht i mendimit: 1) të botohen të gjitha veprat (qi mund të botohen, tue marrë parasysh rrethanat e ndryshme) e Auktorit të naltpërmendun, tue përfshi edhe artikujt e letrat e botueshme; 2) Rendi kronologjik të mbahet vetëm ndër vepra të një dege letrare (prozë e poezi), e edhe ndër këto vetëm ndër ato të njajtës gjini. Proza të rregullohet simbas planit qi ka lanë vetë Auktori: I) Sociologji, II) Polemikë, III) Ligjirata, IV)

*Miscellanea. Në mbarim do të shtohet epistolari. Shkrimet prozaïke pa letra mund të mbërrijn deri në 700 faqe. 3) Veprat të dallohen mbas gjinish: satirika, epika, lirika, dramatika, proza. Përkthimet e ndjeksimet, çfarëdo gjinije t'i përkasin, do të përbajn një vëllim në vete. Në një vëllim të mbaramë do të përfshihen Fragmentat prej veprash të ndryshme. 4) Në botim të veprave të ndiqet botimi i lanun prej Auktorit si difinitiv. Në kjoftë se shndërrimi ka ndodhë për rrethana të jashtëme politike ase ad usum Delphini, të kthehet n'atë përparëshmin, po i u pa gjasa ase nemose të çeket në ndonji fare mënyre. Tue kenë fare i lehtë e i parandsishëm evolucioni i disa trajtave gjuhësore, jemi mendimit të mos çeken aspak në tekst, por, shum shum, mund të theksohen në vëllim të parë të botimit. N'ortografi të ndiqet mënyra e mbrame përdorë prej Auktorit. 5) Në botim të "Opera Omnia" jemi mendimit të lehet komentimi, por të vehet ndonji shënim historik ase rrethanash të nevojëshme, sidomos atëherë kur, pa ndonji ndriçim, nuk kishte me u kuptue si lypet. P. Anton Harapi, Provincjal i Françeskanvet, Shkodër 21.XII.1942".*

**Vendimi i Institutit:** Át Gjergj Fisha ka shkruar ndër të përkohëshme të ndryshme: "Albania", "Dituria", "Dielli". "Përparimi", "Grueja Shqiptare", "Zani i Shna Ndout", "Rivista d'Albania", "Shkëndija", "Leka". Ai ka përdorur këto pseudonime: Mar Pepa, Castigat ridendo, Suta, Fushk në Dushk, Rrushman Sokoli, Rrushmani, Rr. Gegë Toska. P.Gj. e sa të tjerë. Ma të shumten njihet me pseudonimin Gegë Toska. Veprat: E P I K A: Lahuta e Malcis (16838 vargje, Shkodër, Shtypshkronja Françeskane, 1937). Kanga "Marash Uci" përkthehet gjermanisht prej Sommert në "*Neues Wiener Journal*", Wien 1916. Weigand "*Die Berglaute*" "Lahuta e Malcis" von Gjergj Fishta hereaugegeben, Leipzig 1925. "Cubat" e përktheu në italisht Cosmo Parrino tek e përkohëshmjia kulturore "Shkëndija" vj. I, nr. 6. "Oso Kuka" italisht te numri i veçantë "Gjergj Fishta" botue prej së përkohëshmes "Shkëndija" gjithashtu edhe Luigj Gurakuqi "Besa e dhanun" te ky numër i veçantë. Imzot Jul Bonati ka përkthye krejt veprën "Lahuta e Malcis" në gjuhë italishte. L I R I K A: 1. Mrizi i Zanavet (Shkodër, shtyp. Franc., 1941, botimi IV). U përkthyen italisht poezitë "Atdheu", në "Hylli i Dritës", vj. XVIII, n. 5-10. Po në këtë numër edhe "Gjuha Shqipe" e një numër ma vonë "Te gurrat e Jordanit". 2. Vallja e Parrizit (Shkodër, Shtyp. Franç. 1941, botimi III). D R A M A T I K A: Shqiptari i Gjytetnuem (te: Mrizi i Zanavet", botim III, Shkodër. Shqyphtarja e Gjytetnueme (Shkodër, Shtyp. Franç. 1929). Barit e Betlemit (te "Vallja e Parrizit", botim I, Shkodër, Shtyp. Françeskane, 192..., Françesku i Asizit (Shkodër, Nikaj, 1912). Luigj Gonzaga (Shkodër, Zoja e Papërllyeme, 1927). Juda Makabe (Shkodër, Shtyp. Franç. 1923). Odisea. Efigenija n'Aulli (Shkodër, Shtyp. Franç. 1931). Jerina ase Mbretnesha e Luleve (Shkodër, Shtyp. Franç. 1940). S A T I R A: Anzat e Parnasit (Shkodër, Shtyp. Franç. 1928). Gomari i Babatasit (Shkodër, Shtyp. Franç. 1941, botimi II). Të dhënat i përkasin: *AQSH*, F. 200, V. 1943, D. 18.

<sup>28</sup> *Po aty*, F. 200, D. 37. Letrat e zëvendëskryetarit Aleksandër Xhuvani të datës 6.11.1942 dhe Ernest Koliqit të datave 16.11.1942 dhe 21.11.1942. Nga këto letra mësojmë se anëtarë të këtij Komisioni të përgatitjes së "Opera Omnia" të Naim Frashërit do të ishin: Ernest Koliqi, Et'hem Haxhiademi, Lasgush Poradeci, Aleksandër Xhuvani, Hilmi Leka, Át Benardin Palaj dhe Namik Resuli. Në dosjen 18, të Fondit 200 viti 1943, gjejmë **Vendimin dhe listën e veprave të Naim Frashërit të përgatitur nga Instituti:** Pjesa e parë: 1. Historija e Skënderbeut; 2. Qerbelaja. Pjesa

përgatitjen e botimit të punëve të ndryshme të programit të veprimit. Për publikimin e veprimtarisë shkencore, Instituti konceptoi hartimin e një buletini shkencor të titulluar “Studime dhe Tekste”, i ndarë në degë të ndryshme: “1. Dega e Drejtësisë, në numrin e saj të parë përmbante katër studime të rëndësishme mbi Kanunin e Maleve e mbi Rregullat e Esnafëve, si edhe një Pyetësor në ndihmë të atyre që do të kujdeseshin për të mbledhë shënime rreth Kanunit; në fund, ky numër ishte konceptuar të përmbante gati 300 dokumente, sidomos të Mesjetës dhe Epokës Moderne, që ndriçonin traditën juridike shqiptare. Ndër këto dokumente veçoheshin, Kanuni i mbledhur nga Dom Ernest Koci dhe shënimet e dhëna, rreth të drejtës civile të Kanunit, prej të Parit të Djelmnisë së Shalës, Mark Sadikut. 2. Dega e Arkeologjisë përmbante një numër me tre studime të Profesor Sistierit, mbi nënshkrimet latine që gjendeshin në Shqipëri, mbi veshjen ilirike femnore, si dhe mbi statujat e Dianës të gjetura në Apolloni. 3. Dega e Gjuhësisë do të kishte një numër të parë, në të cilin do të paraqitej fashikulli i parë i Fjalorit të Madh të Shqipes, i Mustafa Merlika Krujës”.<sup>29</sup> Është vendi për të shënuar se dorëshkrimi i këtij fjalori ka humbur në të dy kopjet e veta dhe askush nga studiuesit e Akademisë së Shkencave më mbrapa nuk ka “guxuar” të hulumtojë mbi fatin e kësaj vepre madhore të gjuhësisë shqiptare. Fakt është se kopja e këtij fjalori ka qenë dorëzuar në Institutin e Studimeve Shqiptare dhe më pas, krahas veprave të tjera, përfshirë skedarin e

e dytë: 1. Iljada e Omirit; 2. Jetëshkrimi i Naimit prej Lumo Skëndos. Pjesa e tretë: 1. Bagëti e Bujqësija; 2. Lulet e Verës; 3. Parajsa e Fjalët Fluturake; 4. Vjersha; 5. Fletore e Bektashinjvet. Pjesa e katërt: 1. Historija e Shqipërisë; 2. Historizë e Përgjithëshme; 3. Mësimi; 4. Gjithësija; 5. Diturit; 6. Këndimi i Çunavet. Pjesa e parë u përgatit nga profesor Cipo, e dyta nga Z. Haxhiademi, e treta nga profesor Lasgush Poradeci dhe e katërta nga profesor Xhuvani.

<sup>29</sup> *Gazeta Tomori*, Tiranë, 13 mars 1943-XXI. “Veprimtaria e madhe e Institutit të Studimeve Shqiptare”. Në *AQSH*, F. 200, V. 1944, D. 30, gjendet një korrespondencë mes Mustafa Krujës dhe drejtuesve të Institutit Shqiptar për Studime dhe Arte, nga ku marrim këto të dhëna mbi këtë fjalor të “humbur” ndër institucionet, që duhej t’i ruanin shkencëtarët e periudhës së diktaturës. Për hartimin e këtij fjalori Mustafa Kruja kishte punuar 6 vjet me radhë (1928-1933), përveç shtesave që i ka bërë herë mbas here. Në këtë fjalor kanë qenë të shkrimë krejt, tre fjalorët ma kryesorë që kishin dalë deri atëherë për gjuhën shqipe: i Kristoforidhit, i Bashkimit dhe i Meyer-it. Fjalëve të përfshime prej këtyre veprave, Merlika u ka shtue edhe shumë të tjera që ka ditur ai vetë dhe që i ka gjetun të shënuem ndër fjalorë të tjerë ma pak të randësishëm a prej shkrimesh tjera. Letra e parë është e datës 30 prill 1944. Letra e dytë është e datës 8 maj 1944.

terminologjisë prej më shumë se 300 000 skedash, duhet të jetë trashëguar në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë.

Paralelisht me këtë veprimtari, dr. Eqrem Çabej, në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv për Përpilimin e Atlantit Gjuhësor Shqiptar, të kërkuar nga Akademia Mbretnore e Italisë, po zhvillonte një punë të çmueshme dhe kishte arritur të përpilonte Kuestionarin e Atlantit, të plotësuar, punë kjo që mbyllte fazën e parë të projektit, pas së cilës fillonte faza e dytë, ajo e përmbledhjes së lëndës gjuhësore.<sup>30</sup>

Në vjeshtën e vitit 1943, kur Italia kapitulloi, gjermanët erdhën në Shqipëri, ndërkohë që të gjithë prisnin zbarkimin anglo-amerikan në këtë anë të Ballkanit, Instituti u angazhua në përgatitjen e mbrojtjes së çështjes shqiptare dhe trojeve në një konferencë të mundshme të ardhshme të paqes. Në këtë kuadër Instituti Mbretnuer i Studimeve Shqiptare, më 28 shtator 1943, do t'u drejtojë një thirrje intelektualëve shqiptarë për të mbledhur dokumentet e nevojshme dhe çdo dëshmi të shkruar nga të huajt, që do të shërbente për mbrojtjen e të drejtave etnike të kombit. Një komitet i posaçëm brenda Institutit u ngarkua për të mbledhur dokumentet diplomatike, që kishin të bënin me çështjen e kombit shqiptar.<sup>31</sup> Nismëtar i kësaj sipërmarrjeje kolosale, të mençur dhe paraprijëse brenda institucionit ka qenë Mustafa Merlika - Kruja, që para kapitullimit të Italisë, në një letër drejtuar misave të Institutit më 3 shtator 1943, ku kërkon ngritjen e komisionit, përcakton metodikën e punës dhe nivelin e angazhimit për ta arritur në kohë këtë përgatitje.<sup>32</sup> Dua të vë në

<sup>30</sup> Gazeta Tomori, Tiranë, 20 mars 1943, Viti XXI, "Vepra e E. Çabejt për Atlantit Gjuhësor".

<sup>31</sup> AQSH, F. 200, V. 1943, D. 25. Thirrje intelektualëve shqiptarë, firmosur për kryetarin e Institutit të Studimeve Shqiptare nga Aleksandër Xhuvani.

<sup>32</sup> Po aty, F. 200, V. 1943, D. 25. Letër e Mustafa Merlika - Krujës drejtuar Institutit Mbretnuer të Studimeve Shqiptare, Tiranë, më 3 shtator 1943. Ndër të tjera, ai shkruan: "Lufta mizore qi ka zhytun botën në gjak që katër vjet e këndej do të mbarojë një ditë, e ndoshta një ditë ma të shpejtë seç ne mund t'a mendojmë. Njërzi e shtypun e e dërmueme prej saj do të fillojë me lenue e shërue plagët e randa të trupit e të zemrës së vet në bekimin e paqës qi prët. Plagët familjare e plagët kombtare. Por mjerë ata popuj qi si lufta ashtu paqa i gjen të papërgatitun!... A asht vallë populli shqiptar i përgatitun për t'u bamë ballë problemavet para të cilavet do të gjindet qysh ditën qi ka për të pra gjama e topave ndër ballinat e ndryshme të luftës?.... Asht problema e projës së të drejtave t'ona kombtare në Konferencën e Paqës, ma e para problem e paqës për çdo komb, por sidomos për një komb të vogël si i yni, për një komb të vogël e të pafuqishëm me shumë anmiq, me shumë pak miq e pa asnjë tjetër armë veç së drejtës. Vërtetë se edhe kujdesi i ksaj probleme të madhe i përket Qeveris

dukje se, Mustafa Merlika - Kruja në këto kohë të vështira të vitit 1943 gjendej në Tiranë dhe të gjithë aktivitetin e ushtronte nga shtëpia, prej së cilës ai nuk dilte më, për shkak të situatës së pasigurt të rendit publik në kryeqytet dhe kërcënimit të vazhdueshëm për jetën e tij. Takimet me bashkëpunëtorët dhe mbledhjet e komisioneve ku ai ka bërë pjesë, për arsyet e përmendura më lart, janë zhvilluar në studion e tij private.

### **Instituti i Studimeve Shqiptare shndërrohet në Institutin Shqiptar për Studime dhe Arte**

Mbas pushtimit gjerman të Shqipërisë, krijimit të institucioneve të reja independente të shtetit, fillimit të stabilizimit të kuadrit të ri ligjor, Instituti i Studimeve Shqiptare i paraqiti Këshillit të Ministrave, veç projektit të modifikimeve në statutin e këtij institucioni, një raport mbi veprimtarinë e plotë të tij deri në fund të vitit 1943, buxhetin vjetor prej 250 000 fr. shq. dhe skicë-idenë e kanalizimit të veprimtarisë drejt themelimit në të ardhmen të Akademisë Shqiptare të Shkencave, sikurse ngjashëm kishte ndodhur edhe në vendet e tjera ballkanike.<sup>33</sup> Largimi i italianëve nga kontrolli i qeverisë, sovraniteti më i madh në vendimmarrje nga autoritetet vendëse, si dhe administrimi i ri i punëve në shoqërinë shqiptare, krijoi kushte të reja pune dhe lirie edhe për anëtarët e institucionit të shkencës në Shqipëri. Të gjithë studiuesit italianë të

*shqiptare, asht ajo qi do të përfaqësohet, shpresojmë, në Konferencën e Paqës për t'u dale zot të drejtave të kombit shqiptar. Por, gatimi i materjalit të nevojshëm për këtë punë asht një barrë aq' e randë qi vetëm bashkëpunimi i gjithë intelektualvet shqiptarë e gjithë vullneti i mirë i tyne do të mundet t'a qesë në breg si duhet..... Ç'duhet të bajmë për këtë punë?.... 1. Të hartohet një bibliografi e cila të përfshijë të tana veprat qi flasin për Shqipnin e për popullin shqiptar drejt ase tërthuer e rrëshqitas në çdo gjuhë të botës. Pra, një bibliografi jo vetëm shqiptare, por ballkanike. 2. Të lexohen me kujdes të gjitha këto vepra e të daktilografohen në gjuhët origjinale të gjitha pjesët e tyne qi pohojnë të drejtat t'ona kombëtare, sidomos ethnike, tue shënue për secilën pjesë, qoftë edhe një frazë, auktorin, titullin e veprës dhe faqen nga asht marrë.... 3. Këto copa të zgjedhuna me kujdes prej veprash të studjueme mirë, të selekcionohen, të klasifikohen e të botohen me index e racionale, në mënyrë qi të mundet me u gjetun automatikisht se ç'asht folë e kush e ka folë për Kombin shqiptar. 4. Për t'a bamë e kryem në kohë të dobishme gjithë këtë punë duhet bashkëpunimi i të tanë intelektualvet shqiptarë qi kuptojnë mirë një gjuhë të huej (inglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, greqisht, sërbohërvatisht, bullgarisht, rumanisht, tyrgisht) e qi s'përtojnë me këndue... "*

<sup>33</sup> Gazeta *Bashkimi i Kombit*, Tiranë, 31.12.1943, "Një skjarim rreth Institutit të Studimevet Shqiptare".

pranishëm deri atëherë në veprimtarinë e Institutit të Studimeve Shqiptare, pavarësisht se shumica ishin shkencëtarë të mirëfilltë dhe i ishin shmangur përdorimit politik, u larguan, jo vetëm nga anëtarësia e brendshme, por edhe nga bashkëpunimi. Përveç arsyeve të ndryshimit të kuadrit politik që shkaktuan këtë ndërprerje të planeve të përbashkëta të kërkimit shkencor, edhe rrethanat e komunikimit në mes brigjeve u vështirësuan nga zhvillimi i operacioneve ushtarake në Gadishullin Apenin dhe në detin Adriatik dhe dualitetit politik në Itali.

Siç kuptohet nga kronologjia e vendimmarrjeve, Institutit nuk i ka ardhur menjëherë radha e rikonfigurimit **të pozicionit dhe statusit** në shtet. Edhe për 6 muaj të tjerë pas ndryshimit të drejtimit politik dhe ushtarak të vendit, Instituti ka vazhduar punën mbi bazën e titullit dhe kuadrit të mëparshëm ligjor, derisa vëmendja e kryeministrit të ri është adresuar te kjo votër e dijes së naltë. Me kërkesën e Kryeministrit Rexhep Mitrovica, drejtimin dhe riorganizimin e Institutit të Studimeve Shqiptare më 25 shkurt të vitit 1944 e mori Át Anton Harapi, në një mbledhje solemne të zhvilluar në Institut, ku morën pjesë e gjithë trupa e Këshillit të Shtetit, misat e qeverisë, anëtarët e Institutit, Aleksandër Xhuvani, Ekrem Vlora, Anton Paluca, Xhevat Korça, Dhimitër Berati, Dom Lazër Shantoja, Karl Gurakuqi, Odhise Paskali, Lasgush Poradeci dhe gjithë punonjësit e institucionit.<sup>34</sup> **Të nesërmen më 26 shkurt 1944, në Zyrën e Këshillit të Naltë, Át Anton Harapi, në cilësinë e tij si patron dhe drejtues i Institutit, mblodhi anëtarët e caktuar për modifikimin dhe përshtatjen me rrethanat e reja politike, të Misionit dhe Statutit të Institutit të Studimeve Shqiptare, që u caktuan në mbledhjen e një ditë më parë. Ky grup punues përbëhej nga prof. Aleksandër Xhuvani, prof. Karl Gurakuqi, dr. Xhevat Korça dhe prof. Odhise Paskali. Në këtë mbledhje, para së gjithash, u vendos të transformohej emri i institucionit i cili nga kjo ditë e mbrapa do të quhej, **Instituti Shqiptar për Studime dhe Arte**. Po ashtu u vendos që privilegjet të cilat deri në atë kohë i gëzonin të huajt, nënkuptoheshin studiuesit italianë të lidhur me qeverinë e Romës e kohës së Musolinit zot i plotfuqishëm i vendit dikur, të abrogoheshin. Të huajt e çdo kombësie mund të merreshin si anëtarë të jashtëzakonshëm të Institutit, por ata duhej të ishin personalitete të shquara për merita të posaçme në fushën e**

<sup>34</sup> *Gazeta Bashkimi i Kombit*, Tiranë, 26.02.1944. Mbledhja e përgjithshme e Institutit të Studimeve Shqiptare. Fjalimi i Shkëlqesës Patër Anton Harapi.

studimeve albanologjike. Anëtarët e deriatëhershëm shqiptarë të Institutit rikonfirmoheshin. Anëtarët e rinj propozoheshin prej Institutit, ndërsa emërimi i tyre dekretohej vetëm prej Këshillit të Naltë të Shtetit (Regjenca). Anëtarët e brendshëm nuk do të ishin më shumë se 40 vjeç. Në statutin e ri, fjalët “Këshilli i Ministrave”, “Mëkambësija”, “Ministria” zëvendësoheshin me fjalët “Këshilli Naltë”, mbasi Instituti me statutin e ri varej tanimë drejtpërdrejt prej Kreut Kolektiv të Shtetit.<sup>35</sup> Dekretligji mbi organizimin e Institutit Shqiptar për Studime dhe Arte, i përpiluar nga Këshilli i Ministrave më 30 mars 1944, u aprovua nga Regjenca më 22 prill 1944.<sup>36</sup> Institucioni ka funksionuar në pikëpamje administrative mbi bazën e një Rregulloreje mbi Rendimin e Zyrevet dhe Dishiplinën e Personalit të Institutit Shqiptar për Studime e Arte “Pro Kultura”, prej 80 nenesh, një organigramë të kuadrit, me një hierarki dinjitoze të pagave për njerëzit e dijës.<sup>37</sup>

Më 23 prill 1944, ditën e Shën Gjergjit,<sup>38</sup> në orën 10:30 u zhvillua ceremonia e riorganizimit të Institutit në mbledhjen e përgjithshme të misave të tij, nën drejtimin e Kryetarit Át Anton Harapi dhe me praninë e Kryetarit të Regjencës Mehdi Frashëri. Me këtë rast u komunikua “ligja e re, që urdhnonte organizimin dhe aprovimin e Institutit në format të ri,

<sup>35</sup> AQSH, F. 200, V. 1944, D. 25. Dekret Ligjë mbi organizimin e “Institutit Shqiptar për Studime dhe Arte” dhe “Statuti i Institutit Shqiptar për Studime dhe Arte”; shih po ashtu: gazeta *Bashkimi i Kombit*, 26.2.1944, “Statuti i ri i Institutit Shqiptar për Studime dhe Arte”.

<sup>36</sup> AQSH, F. 200, V. 1944, D. 25. Vendim i Këshillit të Naltë i çertifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Këshillit të Ministrave Nedim Kokona, më 22 prill 1944.

<sup>37</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 25. “Rregullorja mbi Rendimin e Zyrevet dhe Dishiplinën e Personalit të Instituti Shqiptar për Studime e Arte ‘Pro Kultura’”.

<sup>38</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 26. Fjala e hapjes së Patër Anton Harapit: “Zotni të ndershëm!, Qe, se duelem në Shën Gjergj! Me dalë në Shën Gjergj, don me thane me e kalue një vjetë e me fillue më të re. Me të mendueme e kemi da të jet dita e Institutit Shqiptar kjo ditë e Shën Gjergjit, qi asht festë shqiptare. Sod pra, “Instituti Shqiptar për Studime e Arte”, ma i nalti organ kulture i ynë, zyrtarisht po fillon një përvjetor të re, përvjetor shqiptar. Inaugurimin e kësaj veprë kulture shqiptare po e bajnë njëmend në çasin ma kritik qi ka kapërcye historia e jonë por me ndërgegjeje të plotë të misjonit, me bindje të vërtetë për gjallsin shqiptar. Më kënaqe të zemres sod poi a çelim dyert të gjitha fuqivet shpirtnore shqiptare, dhe tue i grishë të rreshtohen në ket voter kulture, me gëzim bashkohemi me sa e sa burra e xheni qi në t’ardhmen kanë mprojtë jetën e nderën e fisit t’onë. Qe pra se u shkoi në vend kërkesa sa e sa atdhetarvet të ndritun: Institucjoni i dishruem u ngreh edhe sod me ma t’amblat shpresë nis veprimtarin e vet. Zoti ia dhashtë të marën”.

emnimi i kryetarit dhe u pranuan misat e rinj”. Sipas strukturës së re, Kryetar Nderi u caktua Shkëlqesa Át Anton Harapi, zëvendëskryetar dr. Odhise Paskali. N/kryetarë: prof. Aleksandër Xhuvani për Degën e Letërsisë, dr. Odhise Paskali për Degën e Arteve dhe dr. Hasan Dosti për Degën e Shkencave. Misat e rinj ishin: Fan S. Noli, Mit’hat Frashëri, Ali Asllani, Kristo Floqi, Ekrem Çabej, Krist Maloki, Dom Ndoc Nikaj, Át Pashk Bardhi, Spiro Konda dhe Vasfi Samini. Misat e vjetër u riemëruan. Kryetari i Institutit, në fund të mbledhjes analizuese dhe riprogramuese të institucionit, emëroi edhe misat korrespondentë: Rexhep Krasniqi, Koço Tasi, Hamdi Sulçebe, Vangjel Mexsi, Át Marin Sirdani, Kristaq Cipo, Hamdi Karazi, Jakov Milaj, Dom Ndre Zadeja, Osman Myderrizi, Dhimitër Pasko, Hamdi Kokalari, Ilia Mitrush Panariti, Dom Nikoll Gazulli,<sup>39</sup> dhe bashkëpunëtorët e jashtëm sipas drejtimeve.<sup>40</sup>

<sup>39</sup> *AQSH*, F. 200, V. 1944, D. 1 dhe D. 25. Këshilli i Institutit Shqiptar për Studime e Arte; Misat e Rendshëm t’Institutit Shqiptar për Studime e Arte; po ashtu shih: *Gazeta Bashkimi i Kombit*, Tiranë, e martë 25.4.1944. Mbledhja e Përgjithshme e Misave t’Institutit për Studime e Arte. Në bazë të dokumentit respektiv të AQSH që e cituam më lart, anëtarë të brendshëm të Institutit në vitin 1944 rezultojnë në mënyrë zyrtare: Ali Asllani, Át Pashko Bardhi, Dhimitër Berati, Eqrem Çabej, Hasan Dosti, Aleksandër Stavri Drenova, Kristo Floqi, Mid-hat Frashëri, Karl Gurakuqi, Át Anton Harapi, Etëhem Haxhiademi, Kolë Kamsi, Sotir Kolea, Ernest Koliqi, Spiro Konda, Kristo Kono, Xhevat Korça, Mustafa Merlika-Kruja, Nikolla Lako, Krist Maloki, Dom Ndoc Nikaj, Fan S. Noli, Át Bernardin Palaj, Ndue Paluca, Odhise Paskali, Lasgush Poradeci, Imzot Vinçenc Prennushi, Ilo Mitkë Qafzezi, Namik Resuli, Át Justin Rrota, Vasfi Samini, Dom Lazër Shantoja, Ekrem Vlora, Aleksandër Xhuvani. Ndërsa personel definitiv i Institutit si nëpunësi kanë qenë: Odhise Paskali, Nexhat Haki, Kol Ashta, Vasil Konomi, Hysamedin Hamzaraj, Eftalija Vjero, Besim Vilati, Ndoc Tafili, Vasil Nikolla, Vedat Kokona, Ded Gajtani, Ekrem Vlora, Dom Lazër Shantoja. Misa korrespondues: Dr. Vangjel Mexsi, Hamdi Karazi, Hamit Kokalari, Ingj. Ilia Mitrush. Dr. Jakov Milaj, Dr. Rexhep Krasniqi. Drejtor i botimeve e i përkthimeve Kolë Ashta. Drejtor i Bibliotekës u emërua Prof. Filip Fishta. Po ashtu, Mitrush Kuteli/Dhimitër Pasko, me një letër të veçantë drejtuar Institutit, më datë 25 prill 1944, i njofton se “*Mbassi i nënshkruari nuk e kam krijuar edhe veprën t’ime- as si ekonomist edhe as si letrar - edhe mbassi jam pikërisht dyke punuar për krijimin e kësaj vepre, Ju lutem të kini mirësinë të mirrni shënim se nuk kam mundësi të pranoj emërimin e më sipërmë. Një cilësi e tillë munt të më lypte një kohë të cilën unë s’kam se qysh t’ja sakrifikoj*” . Ngjan të jetë një shmangie elegante nga anëtarësia e Institutit në këto kohë të turbullta.

<sup>40</sup> *AQSH*, F. 200, V. 1944, D. 25. Drejtimet e bashkëpunëtorëve të jashtëm: Prof. Ahmet Gashi – Liceu i Shtetit – Prishtinë; Dr. Gasper Jakova- Profesor i Liceut – Tiranë; Ing. Hasan Zeka – Ministrija e Ekonomisë – Tiranë; Prof. Yzeir Ismaili – Shkolla Tregtare –Vlorë; Dr. Zef Benussi –Rruga Mbretnore – Tiranë; Dr. Martiniani – Gjyqi i Diktimit –Tiranë; Dr. Kolë Dhimitri – Zyrë Advokatore-Tiranë; Prof. Arshi

Më 26 maj 1944, u zhvillua mbledhja tjetër e radhës së Institutit, në të cilën u analizua veprimtaria e deriatëhershme dhe u kompaktësuan drejtimit me rrjedhat e vitit 1944. Nga të dhënat kuptojmë se në Institut zhvilloheshin këto veprimtari dhe po përgatiteshin këto vepra ose dokumente në këtë periudhë: 1. Regjistrimi i dorëshkrimeve; 2. Fjalori i gjuhës shqipe të folun; 3. Fjalori i Botës Shqiptare; 4. Terminologjia e Përgjithshme; 5. Histori e shkurtër e Shqipnisë; 6. Kalendar i shqiptar; 7. Revista; 8. Ligja e pronësisë intelektuale; 9. Bibliografia shqiptare; 10. Katalogu i pjesëve muzikore të adaptueme pak a shumë lirisht në Shqipni; 11. Përpjekja e popullit shqiptar për t'u kulturue: statistika e të diplomuemve. Për sa u përket çështjeve që lidheshin me Kosovën, Instituti kishte fillue veprimtarinë, në bashkëpunim me entet dhe me Lidhjen e Dytë të Prizrenit me këto pikësnyime: 1. Vlerat e Kosovës në të kaluemen dhe në të tashmen; 2. Landa e vlefshme për dftojnsin - monografi të Shqipnis; 3. Ndhmesë për Fjalorin e Botës Shqiptare; 4. Bashkëpunim me anë të një komisioni për mbledhjen e landës së posaçme që dëshmon për të drejtat t'ona etnike mbi Kosovën.<sup>41</sup>

Më 11 maj 1944, Át Anton Harapi i drejtoi një shkresë Kryesisë së Këshillit të Ministrave, në të cilën e informon mbi aktivitetin e Institutit, në kushtet e vështira ekonomike që po kalonte shteti, në rrjedhën e ngjarjeve ushtarake të vitit 1944, duke kufizuar shpenzimet në 5 kapituj,

Pipa -Liceu i Shtetit – Tiranë; Prof. Aleks Buda – Liceu i Shtetit –Tiranë; Át Benardin Palaj – Kuvendi Françeskan – Shkodër; Át Donat Kurti –Kuvendi Françeskan – Shkodër; Agr. Sherif Frashëri- Ministrija e Ekonomisë – Tiranë; Ing. Andrea Xega – Drejtorija e Minierave –Tiranë; Sotir Kondi –Kryetar Seksjoni i Ministrisë së Ekonomisë – Tiranë; Prof. Sadik Kaçeli – pranë Magazinës Kaçeli – Tiranë; Asaf Xhaxhuli – Stamboll (Turqi); Anton Krajni – Ministrija e Arsimit - Tiranë; prof. Gabriel Meksi – Rruga Dhimitër Kamarda 118 – Tiranë; Hamdi Bushati – Shkodër; Dr. Injac Ndojaj – Profesor i Liceut Shkodër; Prof. Mihal Zallari – Kryetar Parlamenti – Tiranë; Agr. Masar Kallajxhi – Inspektor Epror i Ministrisë së Ekonomisë – Tiranë; Petraq Peppo – Libraria Peppo –Tiranë; Sulejman Mujazhi – Stamles – Shkodër; Dr. Venamin Dashi -Liceu Normale – Elbasan; Prof. Jonuz Blakçori – Rruga Fortuzi 61 – Tiranë; Pjetër Dingu – Radio Tirana - Tiranë; Niko Konda – Ministrija e Kulturës Popullore- Tiranë; Pashko Milaj – Statistika – Tiranë; Prof. Izett Bebeziqi – Ministrija e Punëve të Jashtme –Tiranë; Selman Riza – Biblioteka Kombëtare – Tiranë; Xhafer Belegu – Ministrija e Punëve të Jashtme - Tiranë; Patriarku Joakim – Atenes; Sotir Caci “Likaviti” Atenes, Qemal Mersacé - Odhes; Fiulante Alberto- Frashëri 73-Bulevardi i Madh; Selman Riza – Lidhja e II e Prizrenit.

<sup>41</sup> Gazeta *Bashkimi i Kombit*, Tiranë, e shtunde 27.5.1944. Mbledhja e Përgjithshme e Institutit Shqiptar për Studime e Arte.

por duke shtuar dy kapituj me rëndësi kombëtare, që lidheshin me përgatitjen e bazës dokumentare dhe argumentuese për diplomacinë e shtetit, kur lufta të përfundonte dhe rendi i ri politik europian do të shtrohej për diskutim mes fuqive fituese. Ndër kapitujt e shtuar ishin: 1- Monografia - Guidë e titulluar “Shqipnija”, një vëllim që konsiderohej i domosdoshëm për t’u përgatitur, për ta pasur me vete, një dërgatë e ardhshme diplomatike që do të mbronte çështjen kombëtare dhe shtetërore në Konferencën e Paqes. Kjo monografi do të ishte e pajisur me dokumente të papërgënjeshtreshme mbi të drejtat etnike shqiptare si racë dhe si komb. 2 - Veprim për studime mbi Kosovën, që ishte një program shkencor dhe kombëtar njëkohësisht. 3- Fjalori i Botës Shqiptare për të cilin po zhvilloheshin punimet përgatitore dhe që në thelb ishte një fjalor historik i së shkuarës, si komb dhe si racë. Këto vepra në tërësi, konceptoheshin nga drejtimi i Institutit me një rëndësi të posaçme për pohimin e të drejtave kombëtare kundrejt botës.<sup>42</sup> Në këtë

<sup>42</sup> *AQSH*, F. 200, V. 1944, D. 14. Letër e Patër Anton Harapit drejtuar Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Tiranë, 11 maj 1944. “Guida: qëllimi i kësaj vepre i tejkalonte arsyet turistike, përbënte një vëllim të denjë që do t’i shërbente një dërgate diplomatike, që fliste me dokumente të papërgënjeshtreshme mbi të drejtat shqiptare si racë dhe si komb, mbi të drejtat etnike në Kosovë dhe Çamëri. Ky vëllim duhej përgatitur sa më parë, mbasi ideatorët e mendonin me të drejtë, se kufijtë e shteteve do të diskutoheshin mbas luftës dhe Guida do të shërbente si një instrument i fuqishëm në duart e miqve të Shqipërisë dhe si një qëndresë e fortë ndaj atyre që donin ta copëtonin atë. Guida do të botohej në një ose dy gjuhë të huaja. Përmbajtja e saj do të ishte si më poshtë: I. Gjeografia: Emri- sipërfaqja- malet- lumenjt-klima-fauna- flora. II. Historia -A) Historia politike: Prehistoria - Ilirët- Shqipnija kundër Romës- Skëndërbeu - Shqipnia ndënjë Osmanllitë- Shqiptarët përjashta - Bijtë e Shqipërisë- Përpjekjet për pavarësi - Shqipnia e Lirë- Konoitë. B) Arkeologji C) Fetë Ç) Zakonet D) Kanuni i Lek Dukagjinit dhe traditat juridike të Labërisë - III: Letërsi dhe Arte: Jeta Kulturore- Shoqnitë Letrare dhe Artistike- Gazetaria- Gjuha Shqipe- Letërsia- Artet plastike- Muzika- Artet Popullore - Folklori- Legjenda. IV: Bujqësi dhe Blegtori: Prodhimet e tokës - Pyjet - Gjëja e gjallë-. V: Industri dhe Tregti: Nëntoka- Industritë- Zejet - VI. Tregtia. Statistika: veprimtaria e 30 vjetvet të fundit në të gjitha fushat. VII: Turizëm: intenerarët e ndryshëm për të njohur Shqipërinë duke ilustruar qytetet, katundet, fushat, lumenjt nga pikëpamja historike, shoqërore, tregtare etj. Teksti do të përmbante harta gjeografike të ndryshme - Grafikë statistikore- fotografina të pamjeve piktoreske, të qyteteve, të viseve historike dhe arkeologjie, vepra arti- kostume – zejtarinumerizmatikë - filatelikë - ikonografi etj.”

Për Fjalorin e Botës Shqiptare, shih: *AQSH*, F. 200, V. 1944, D. 29. Lënda e Fjalorit do të ishte si më poshtë vijon: a) SHQIPTARËT E PËRMENDUN: Dëshmorët e Atdheut - Atdhetarët e mëdhenj të vdekur - Arsimitarët apostuj të shqiptarizmsë - Luftëtarët-Diplomatët-Politikantët-Strategët-Princërit, Mbretërit, Perandorët dhe Papët

kuadër, përfshihen edhe vendimet që mori Komisioni i Gjuhësisë dhe i Etnografisë për përkthimin e veprave shkencore që flisnin për Shqipërinë.<sup>43</sup>

Kosova ishte në kulmin e synimeve dhe sulmeve për rimarrje nga ana e të dyja forcave politike rivale në Serbi në verën e vitit 1944, komunistëve të Titos dhe çetnikëve të Mihajloviçit. Vetë Shqipëria ishte në kulmin e kaosit, ndërkohë, në një ndërtesë në Tiranë, dhe dhjetëra studio të improvizuara në shtëpitë private, burrat më të ditur të kombit i paraprinin historisë me punën e tyre të vyer. Ata nuk e ndërprejnë në asnjë çast veprimtarinë e tyre studimore dhe botuese edhe kur krismat

prej race shqiptare - Poetët - Shkrimtarët-Gazetarët-Piktorët-Skulptorët-Arkitektët-Muzicistët-Ingjenierët-Bamirsit-Fetarët-Profesionistët-Zejtarët-Karakteret-Kuriozitetet - Grat e përmendura etj. B) SHQIPNIA ETNO-GJEOGRAFIKE: Fiset shqiptare-familjet e përmendura-katundet-Qytetet-Kështjellat-Kishat- Xhamijat- Teqetë-Manastiret-Kuvendet fetare-Lumenjt-Malet-Fushat-Qafat-Rrugët e viseve historike-Gërmadhat etj. C)BURRAT E PËRMENDUR PREJ ORIGJINE SHQIPTARE: Në Turqi, Greqi, Bullgari, Rumani, Jugosllavi, Itali, Egjypt, Rusi, Amerikë e gjetkë. ç) VISE TË HUAJA TË BANUARA OSE JO PREJ SHQIPTARËSH QË KANË LIDHJE ME HISTORIN SHQIPTARE. d) TË HUAJT QË PËR TË MIRË A PËR TË KEQE JANË MARRË ME SHQIPNIN DHE SHQIPTARËT. dh) SENDE E FJALË QË SHPREHIN NJË KARAKTERISTIKË TË SHQIPNIS OSE VETËM TË NJË KRAHINE. Burimet e lëndës: 1) Antologjia e Ministris s'Arsimit. 2. Lënda e mbledhur me rasën e 25- vjetorit të Pamvarsis (pranë z. Beratti) 3. Lënda e zgjedhur prej z. Ekrem Vlora. 5. Lënda e z. Rosolino Petrotta mbi shqiptarët e Italisë. 10) Lënda e mbledhur prej z. Lasgush Poradeci mbi shqiptarët e Rumanisë.

<sup>43</sup> *AQSH*, F. 200, V. 1944, D. 32. Komisioni i Gjuhsis dhe i Etnografis mori këto vendime: “1. Që Instituti të vijë në marrëveshje me Z. Dr. Zef Skiroj për veprat qi ka lanë xhaxhai i tij. Këto janë: një Fjalor i Buzukut, një fjalor përgatitje të botimit të Buzukut, një Fjalor të Budit, Fjalorin e Bardhit, një Gramatikë Deskriptive mbi Shkrimtarët e Vjetër. Gjithashtu Imzot Pal Skiroj ka lanë edhe një bibliotekë të pasun. 2. Që të botohen veprat e Imzot Skirojt, Fjalori i bimve i Ingj. Ilia Mitrushit, fjalorët e Eqrem Çanos, Prof. Zihni Sakos, Nikolla Lakos, Naço Kutrës. 3. Që të përkthehen veprat shkencore qi flasin mbi Shqipni: I) Hecquard - Histoire et description de la Haute Albanie, V.I, II, (përkthyes Prof. Selman Riza); II) Albanesische Studien (përkthyes Prof. Anton Krajni); III) Nopsca – Albanien (përkthyes Hasan Ceka); IV) Lambertz – Prralla shqiptare (përkthyes Lasgush Poradeci); V) Luis – Albanien (përkthyes Ingj. Ilia Mitrushi); VI) Urban – Banesat e Shqipnis jugore (përkthyes Ingj. Jovan Adami); VII) Thunmann – Popujt e Europës lindore (përkthyes Prof. Veniamin Dashi); VIII) Durham – Some tribal (përkthyes Dr. Selahyidin Toto); IX) Hobbhouse – Udhtimi në Shqipni (përkthyer nga Aleks Buda); X) Selishef – Slavianskoe naselenie (përkthyes Mihal Sherko); XI) Skura – Gli Albanesi d’Italia (përkthyes Ali Hashorva); XII) Masci –Discorsa sugli albanesi d’Italia (përkthyes Kolë Ashta); XIII) Almagià – Albania (përkthyes Dr. Gaspër Jakova).”

dëgjoheshin në bulevardin kryesor të kryeqytetit, si besnikë të shtetit, kombit dhe qytetarëve shqiptarë, deri në fund, kur forcat e errësirës do të mbulonin Tiranën, Shkodrën, Gjakovën, Prizrenin, Elbasanin dhe Korçën etj., me gjak. Punimet e Seksionit “Kosova” nisën në kulmin e luftës, më 8 qershor 1944, dhe kanë marrë fund më 6 tetor 1944, në ditët kur shteti po dezintegrohej me shpejtësi marramendëse. Puna e këtij seksioni ka synuar kryesisht përpilimin e një dokumentari historik-statistikor mbi Kosovën, si dhe mbledhje dokumentesh ndër arkiva të ndryshëm rreth po kësaj çështjeje.<sup>44</sup> Seksioni “Kosova” ishte i përbërë prej studiuesish të çështjeve etnike shqiptare dhe prej intelektualësh të Kosovës. Qëllimi i krijesve të këtij seksioni dhe i Komisionit gjegjës ishte mbledhja e lëndës dhe e dokumenteve mbi çështje historike, ekonomike, artistike, shkencore dhe përgjithësisht kulturore, që kishin të bënin me Kosovën dhe viset e tjera të Shqipërisë etnike. Puna e seksionit ishte konceptuar nga ideatorët që të bëhej përmes një bashkëpunimi sa më të ngushtë me të gjitha entet dhe privatët që zotëronin një kompetencë diturore në degët e shkencës të lidhura me studimin e Kosovës dhe viseve shqiptare të integruara rishtazi në shtet.<sup>45</sup> Profesori i kimisë dhe shkencave të natyrës pranë Liceut Kombëtar “Gjergj Fishta” në Shkodër, dr. Injac Gj. Ndojaj, që ishte edhe korrespondent i Institutit, i kërkoi autoritetit drejtues të institucionit, që në kuadrin e nismës për mbrojtjen edhe intelektuale të etnicitetit shqiptar të Kosovës, të themelohej një komision, i cili do të shkonte në Kosovë për të kryer matje e rivelacione bio-antropometrike. Ky komision do të duhej të përbëhej prej dy studiuesve të shkencave natyrore, me të cilët zëvendësoheshin antropologët e specializuar që mungonin në Shqipëri, dy mjekë, një historiano-gjeograf, një linguist ose entolog dhe një alpinist udhëheqës. Propozimi i bazuar mbi qasjen e studimit antropologjik të etnicitetit, synontetë të vërtetonte, se banorët e Kosovës ishin historikisht dhe në pikëpamje të prejardhjes fizike, shqiptarë dhe autoktonë.<sup>46</sup> Koha e shkurtër në dispozicion dhe rrethanat e pasigurta, me sa kuptohet, nuk e kanë mundësuar shqyrtimin e këtij propozimi dhe ngritjen e komisionit. Ndërkohë, prof. Avni Zajmi mori nismën për të hartuar një vepër mbi

<sup>44</sup> *AQSH*, F. 200, V. 1942, D. 21. Shih: Nxjerrë nga radhorët e Institutit.

<sup>45</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 26. Qarkore e zv. Kryetarit dr. Odhise Paskali për anëtarët e Seksionit Kosova, Tiranë, më 12.06.1944, nr. prot. 105/6.

<sup>46</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 43. Letër e Injac Gj. Ndojaj drejtue Odhise Paskalit, Shkodër, 8.4.1944.

Kosovën, duke përfshirë në përmbajtjen e saj, të gjitha lëvizjet e zhvilluara nga qeveria qendrore nëpërmjet dikastereve dhe drejtorive të përgjithshme, si nga pikëpamja administrative, ashtu edhe nga pikëpamjet kulturore, arsimore, ekonomike etj., “që nga data e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë e vitit 1913”.<sup>47</sup> Pra, në Institut punohej njëllonj deri në ditët e fundit para hyrjes së partizanëve në Tiranë, me rigorozitet dhe përgjegjësinë e shërbestarëve të kombit dhe shtetit.

Për shkak të ndryshimit rrënjësor të gjendjes politike dhe juridike pas kapitullimit të Italisë, me një dekret të veçantë në dispozicion të Institutit u vendosën edhe pasuritë e Fondatës “Skanderbeg”, e cila që nga data 1 gusht 1943 nuk funksiononte më. Kjo sepse Instituti ishte i vetmi institucion i përshtatshëm për të pasur në dispozicion atë pasuri.<sup>48</sup>

Po ashtu u përpilua Radhori Emnor i Shqiptarëve që merreshin me letërsi, arte dhe shkencë, i përpjesëtuar në degët dhe specialitetet e ndryshme.<sup>49</sup> Instituti përgatiti një Fletë Bio-Bibliografike, e cila ishte një

<sup>47</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 43. Shkresë e zv. Kryetarit të Institutit Odhise Paskali drejtuar të gjitha institucioneve shtetërore nga qeveria, ministritë dhe dikasteret, më 10.10.1944.

<sup>48</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 8. Projekt Dekret Ligjë mbi vumjen në dispozitë t’Institutit Shqiptar për Studime dhe Arte të pasunis së Fondatës Skanderbeg. Raport justifikues.

<sup>49</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 25. Radhori: I. Letërsi: 1. Poezi: Fan Noli, Asdreni, Vinçenc Prennushi, Lasgush Poradeci, Etëhem Haxhiademi, Ali Asllani, Ernest Koliqi, Petro Marko, Nexhat Haki, Vedat Kokona, Sotir Caci, Aleks Çaçi, Dhimitër Shuteriqi, Thanas Konomi, Gjergj Komnino, Perikli Mborja, Sejfullah Malëshova, Zissa Cikuli, Gjergj Bubani, Luigj Filaj, Kudret Kokoshi, Vexhi Buharaja, Tanush Ismailati, Manush Peshkëpia, Guljelm Deda, Luçia Seregji (Lux Secreta), Beqir Çela, Arshi Pipa, Pjetër Gjini, Andrea Varfi, Anton Mazreku, Jusuf Luzaj, Kolombia (Selfixhi Ciu- Broja), Kristaq Cepa (Kappa), Hito Sadik, Kol Ashta (Shkaba), Yzedin Jashar Kutrulia (Dhimitër Pasko), Kristo Floqi, Ramiz Harxhi, Skënder Arrëza, Bardhyl Pogoni, Milto Sotir Gurra, Muzafer Xhahi, Mark Ndoja, Shefqet Musaraj, Gjysh Bektashi Kolonja. 2. Theatër: Fan Noli, Kristo Floqi, Etëhem Haxhiademi, Dom Ndre Zadeja, Konstandin Kotte, Gjergj Komnino, Xhelal Broja, Stefan Shundi, Vinçenc Prenndushi, Injac Zamputi, Zoi Xoxa, Skënder Luarasi, Jusuf Luzaj. 3. Novelë: Lumo Skëndo, Ernest Koliqi, Vedat Kokona, Sterjo Spasse, Pjetër Deda, Ndoc Logoreci, Stefan Shundi, Lipi (Filip Papajani), Veis Sejko, Filip Ndocaj, Lazzar Eftimiadhi, Hilmi Leka, Selahudin Toto, Anton Frashëri, Milto Sotir Gurra, Haki Stërmilli, Nonda Bulka, Astrit Delvina, Osman Bishqemi, Sotir Caci, Jani Lili, Injac Zamputi, Anton Mazreku, Musine Kokalari, Dhimitër Shuteriqi, Vasil Alarupi, Petro Marko, Selfixhe Ciu (Kolombia), Remzi Xheneti, Kuteli (Dhimitër Pasko), Andrea Skanjeti, Shemshedin Vendresha, Qukapiku (Qamil Guranjaku). 4. Roman: Dom Ndoc Nikaj, Át Anton Harapi, Mehdi Frashëri, Sterjo Spasse, Luigj Thaçi, Haki Stërmilli,

Kolec Prendushi. 5. Prozë Arti: Veis Sejko, Perikli Mborja, Zef Dukagjini, Kol Ashta, Nonda Bulka, Ndoc Logoreci, Ernest Koliqi, Stefan Shundi, Jani Lili, Guljelm Deda, Qamil Draçini, Mit-hat Araniti (Rem Vogli), Behar Shtylla, Remzi Xheneti, Vedat Kokona, Nexhat Haki, Mehmet Ali Beqiri, Tefë Krraqi, Çesk Kabashi. 6. Përkthime: Anglisht: Selahudin Toto, Ali Kuçi, Anton Frashëri, Anton Logoreci, Fan Noli, Beqir Çela, Skënder Luarasi, Hito Sadi, Stavro Skëndi, Kostë Çekrezi, Beqir Haçi, Stavro Frashëri, Ramiz Treni, Aqile Tasi, Aldo Çoba, Llazar Fundo. Armenisht: A. Burnazian. Bullgarisht: Sterjo Spasse. Frëngjisht: Enver Fico, Lazar Eftimiadhi, Skënder Avëza, Foto Bala, Nonda Bulka, Ernest Koliqi, Sotir Caci, Behar Shtylla, Luigj Ljarja, Anton Mazreku, Dhimitër Shuteriqi, Jusuf Luzaj, Tajar Zavalani, Abaz Ermenji, Remzi Xheneti, Vedat Kokona, Selman Riza, Petro Korçari, Dhimitër Falo, Lefter Dilo, Hamit Kokalari. Gjermanisht: Aleks Buda, Izet Bebeziqi, Lazër Shantoja, Gaspër Shoshi, Fan Noli, Skënder Luarasi, Karl Gurakuqi, Jovan Adami, Eqrem Çabej, Selman Riza, Ndue Paluca; Greqishte e re: Aleks Çaçi, Jani Mili, Petro Marko, Thanas Konomi, Aleks Mavraqi, Dhimitër Falo, Timo Dilo, Sotir Papakristo, Gabriel Meksi, Spiro Çomorra. Greqishte e vjetër: Frano Alkaj, Pashko Gjeçi, Henrik Lacaj, Sotir Papakristo, Timo Dilo, Gabriel Meksi. Italisht: Mark Ndoja, Pashko Gjeçi, Cuk Simoni, Jolanda Kodra, Kudret Kokoshi, Andrea Shuli, Muzafer Xhaxhi, Manush Peshkëpia, Ernest Koliqi, Stefan Shundi, Lazër Shantoja, Andrea Varfi, Dedë Gajtani, Gjon Kovaçi, Guljelm Deda, Injac Zamputti, Anton Mazreku, Nexhat Hakiu, Kolë Ashta, Karl Gurakuqi, Mark Harapi, Besim Qorri (autori i librit: “Shqipnija e vërtetë-Studim Historik dhe Ethnografik, Tiranë 1944), Lefter Dilo. Latinisht: Frano Alkaj, Pashko Gjeçi, Henrik Lacaj, Nikollë Dakaj; Persisht: Vexhi Buharaja, Fan Noli. Rumanisht: Lasgush Poradeci, Dhimitër Pasko, Gjergj Bubani, Sinjari. Rusisht: Sejfullah Malëshova, Milto Sotir Gurra, Mihal Sherko, Tajar Zavalani, Fan Noli, Llazar Fundo, Selim Shpuza (Harbuti - pseudonimi). Serbisht: Veis Sejko, Mid-hat Araniti, Vasil Trimçev, Vasil Llazari, Mark Temali, Sokoli, Lazër Radi. Spanjisht: Pjetër Deda. Turqisht: Jonuz Tafilaj, Vasfi Samini, Shemsedin Vendresha, Sherif Putra, Baba Ali Tomori. Përkthime nga shqipja: Italisht: Jolanda Kodra, Kosmo Parino, Renato Baldini. Gjermanisht: Aleks Buda, Eqrem Çabej. Letërsi për fëmijë: Frano Gjellaj, Tom Gjyshaj. Beqir Haçi. II. Arte: 1. Muzikë: Fan Noli, Kristo Kono, Ludovik Naraçi, Thoma Nasi, Luigj Filaj, Baki Kongoli, Lec Kurti, Pjetër Dingu, Kostandin Trako, Mikel Koliqi, Ramadan Sokoli. 2. Pikturë: Vangjush Mio, Andrea Thanasi, Zef Kolombi, Sadik Kaceli, Foto Stamo, Hasan Reçi, Abdurahim Buza, Simon Rrota, Kenan Messarea, Fadil Pullumi, Androniqi Antoniu - Zengo, Sofia Zengo, Hysen Devolli, Mir Papajani, Vangjush Tushi, Qamil Grezda, Kel Kodheli, Ibrahim Kodra, Bukurosh Sejdini, Nexhmedin Zajmi, Vasil Toli, Shefqet Agalliu, Abdullah Emini, Vera Blloshmi, Shima, Babani, Vladimir Jani, Vangjeli Borova. 3. Skulpturë: Odhise Paskali, Janaq Zafiri Paço, Mihal Zallari, Llazar Nikolla, Sabri Tuçi, Kristina Hoshi – Koljaka, Andrea Mana, Stefan Mara, Kol Shala. 4. Arkitekturë: Qemal Butka, Anton Luffi, Skënder Luarasi, Kroqi. 5. Ekzekutorë Muzike: Tonin Guraziu (Pjano), Lola Gjoka Aleksi (Pjano), Ludovik Naraçi (Vjolinë) Foti Filipeo (Vjolinë), Baki Kongoli (Vjolinë), Sokrat Mio (Vjoloncel). 6-a) Këngë: Kristaq Antoniu (tenor), Kristo Kono (bariton), Mihal Ciko (Bariton), Maria Kraja Paluca (Soprano e lehtë), Tefta Tashko Koço (soprano e lehtë) Behije Çela, Liza Varfi. 6-b)

Drejtor Koresh: Sotir Kozmo, Luigj Filaj, Gjeorgjia Truja Filçe, Kostandin Trako. 7.a) Recitime: Fiqret Ftera, Sokrat Mio. 7. b) Rezhi: Sokrat Mio, Fiqret Ftera. 8 Studime t'Artit: Odhise Paskali (Arte Figurative) Perikli Mborja (Arte Figurative) Kostandin Trako (Muzikë) Injac Gj. Ndoja (Muzikë). Vasfi Samini (Theatër), Eqrem Vlora (Zejtari). 9. Arkeologji: Hasan Ceka, Jovan Adam, Aldo Çoba, Yzeir Ismaili, Jonuzi. 11. Kinematografi: Kristaq Antoniu. 12. Fotografi Arti: Kristaq Sotiri - Korçë. III. Studime: 1. Gjuhësi: Eqrem Çabej, Namik Resuli, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Justin Rrota, Karl Gurakuqi, Mustafa Kruja, Kolë Kamsi, Gjon Ujka, Dhimitër Beratti, Koço Tasi, Selman Riza, Nelo Dizdari, Ndue Paluca, Gaetano Petrotta, Simon Shuteriqi, Osman Myderizi, Sotir Kolea, Pano Tasi, Nikollë Gazulli, Mahir Domi. 2. Kritikë Letrarë: Aleks Buda, Mark Ndoja, Selahudin Toto, Pashko Gjeçi, Izet Bebeziqi, Ziahudin Kodra, Krist Maloki, Ernest Koliqi, Behar Shtylla, Jani Lili, Kolë Prela, Ndoc Logoreci, Fan Noli, Arshi Pipa, Qemal Draçini, Skënder Luarasi, Vedat Kokona, Nexhat Haki, Sterjo Spasse, Kolë Ashta, Lasgush Poradeci, Dhimitër Pasko, Filip Fishta, Timo Dilo, Jakov Milaj, Vasfi Samini, Anton Doçi, Eqrem Çabej, Namik Resuli, Branko Merxhani, Gaetani Petrota, Gjon Kamsi, Stefan Shundi, Sejfullah Malëshova. 3. Histori: Fan Noli, Ndoc Nikaj, Ilo Mitkë Qafzezi, Athanas Gegaj, Dhimitër Beratti, Hamit Kokalari, Petraq Pepo, Kost Çekrezi, Rozolin Petrota, Rexhep Krasniqi, Mehdi Frashëri, Lef Nosi, Benedikt Dema, Xhemal Bejlegu, Osman Myderizi, Lluk Karafili, Sotir Kolea, Stavro Skëndi, Xhevat Korça. 4. Filozofi: Branko Merxhani, Fejzi Dika, Mark Dema, Sotir Papristo. Pedagogji: Aleksandër Xhuvani, Sotir Papahristo, Beqir Sinani, Ali Hashorva, Gabriel Meksi, Skënder Sejдини, Beqir Haçi, Zenel Hekali, Gjon Shllaku, Kolë Koci, Abdyl Kajanaku, Hidajet Ceka, Stefan Treska, Kasem Bajrami, Jonus Blakçorri, Lirak Dodbiba. 6. Jurisprudencë: Vangjel Meksi, Zef Benussi, Gjergj Ashta, Suat Asllani, Ndrek Kakarriqi, Kol Dhimitri, Hasan Dosti, Thoma Orollogaj, Terenc Toçi, Ndoc Gaspri, Mirash Ivanaj. 7. Folklor: Mihal Sherko, Sterjo Spasse, Ilo Mitkë Qafëzezi, Ilija Mitrushu, Nikollaq Kotte, Nikolla Lako, Eqrem Çabej, Át Aleksandër Sirdani, Át Benardin Palaj, Át Donat Kurti, Rebi Alikaj, Rrok Zojzi, Gjush Sheldija, Peter Elezi, Hasan Reçi, Stavro Frashëri, Át Gjon Karma. IV. Shkenca: 1. Matematikë: Nush Radovani, Anthin Konomi, Nexhat Peshkëpia, Vangjel Gjirkondi, 4. Mineralogji: Andrea Xega, Dhori Pano, Sulo Klosi. 5. Mjekësi: Alimihali, Spiro Çipi, Petraq Leka, Jorgj Jorgoni, Hajrullah Harxhi, Hamdi Sulçebe, Maliq Bekteshi, Sezai Agalliu, Sotir Polena, Federik Shiroka. 6. Shkenca Natyrore: a. Botanikë: Stiljan Gaxho, Nikolla Lako, Ilija Mitrushu. b) Zoologji: Vasfi Samini, Gjon Kiri, Isuf Allamani, Mas-har Kallajxhi, Mas-har Dervishi, Zef Kakarriqi. c) Bujqësi: Mas-har Kallajxhi. 7. Edukatë Fizike: Gaqo Gogo, Luigj Shala, Anton Mazreku. 8. Ekonomi – Financë: Mehdi Frashëri, Zija Bejleri, Dhimitër Pasko, Haxhi Shkoza, Jakov Milaj. Ekstra A. Gazetari: Nebil Çika, Timo Dilo, Aleksa Mavraqi, Rosolin Petrota, Gjergj Bubani, Stefan Shundi, Zef Malaj, Tajar Zavalani, Lazër Shantoja, Ali Kuçi, Thoma Frashëri, Nikë Barcolla, Gjergj Ashta, Xhevat Kallajxhi, Mehdi Frashëri, Maz-har Sopoti, Teki Selenica, Niko Konda, Branko Merxhani, Mirash Ivanaj, Petro Korçari, Dhimitër Falo, Leonidha Naçi, Seid Kemali, Lazër Radi, Pandi Frashëri, Vasfi Samini, Hilmi Leka, Vasil Alarupi, Hamdi Karazi, Lefter Dilo, Zoi Xoxa, Mihal Xoxe, Omer Nishani, Akile Tasi, Gaqo Gogo, Demir Alizoti, Konstandin Kotte, Fiqiri Llagani, Sejfullah

statistikë e dorëshkrimeve origjinale, ose të përkthyer, të gatshme, ose në punim e sipër, që gjendeshin asokohe në Shqipëri. Instituti studioi mënyrën për të dërguar në shtyp një “Histori të Shqipërisë”, një “Monografi Udhëheqje të Shqipërisë”, dhe duke u bazuar në modelet e ngjashme të huaja do të ruante pikëpamjen shqiptare në të gjithë përmbajtjen. Ajo synonte të shërbente si udhëheqje në mbrojtjen e çështjes shqiptare mbas luftës në konferencat e paqes. Kalendar i Shqiptar,<sup>50</sup> që do të ishte një enciklopedi e vogël e gjithë veprimeve shoqërore dhe kulturore të vendit sipas shembujve të huaj.<sup>51</sup> Ndër botimet që duhet të përmendim, ishte edhe Antologjia e Letërsisë Shqipe deri në vitin 1944 e titulluar: “Shkrimtarë të Shqipnisë”. Ky koleksion përmblihte të ribotuara veprat më me rëndësi të letërsisë shqipe prej Buzukut deri tek autorët bashkëkohorë të asaj periudhe,<sup>52</sup> si dhe

Malëshova, A. Burnazian, Harbuti (pseudonim i Selim Shpuzës), Kol Ivanaj, Karl Çoba, Eqrem Telhaj, Rexhep Mitrovica, Xhelal Mitrovica, Ferid Vokopola, Avni Zajmi, Mark Temali, Shemsedin Vendresha, Guljelm Deda, Sherif Putra, Baba Ali Tomori, Javer Hurshiti, Kristo Floqi, Milto Sotir Gurra, Koço Semini, Jani Lili, Beqir Haçi, Tahir Zajmi. Ekstra B. Jetë Femnore: Maria Kraja, Tefta Koço Tashko, Lola Gjoka Aleks, Hoxhi Koljaka, Gjeorgjia Truja Filçe, Androniqi Antoniu Zengo, Sofia Zengo, Vera Blloshmi, Ollga Plumbi, Mila Gjokoreci, Musine Kokalari, Selfixhe Broja (Kolombia), Eleni Lezo (Vjollca e Skanderbeut), Luçia Seregji (Lux Secreta). Profesorë Muzike Kompozitorë dhe Kangëtorë Shqiptarë: Prof. Kristaq Kono, Prof. Konstandin Trako, Prof. Sotir Kozmo, Prof. Misto Falli, Don Mikel Koliqi, Don Zef Shestani, Kol Jakova, Prof. Spiridon Konda, Prof. Kotta, Zonja Gjorgjia Truja (Filçe), Zonja Lola Gjoka (Aleksi), Zonja Maria Kraja (Paluca), Zonja Tefta Koço (Tashko), Tonin Guraziu, Pjetër Dungu, Bakë Kongoli, Prof. Foto Filipeo, Prof. Krasta, Prof. Prokop Sorra, Kristo Çeko, Efthin Derri, Luigj Filaj, Kristo Koçi, Kristaq Antoniu, Prek Jakova, Merita Sokoli, Viktoria Xhaçka, Bardyle Nasse.

<sup>50</sup> Ishte një botim i përvitshëm në formën e një enciklopedie të vogël mbi të gjitha veprimet shoqërore dhe kulturore të vendit, sipas shembujve të njëlllojshëm të huaj, por me lëndë kryesisht kombëtare. Ishte parashikuar që në dhjetorin e vitit 1944 të dilte kalendar i vitit 1945, i cili do të përmbante: Përvjetorë historikë - krahasime me riprodhim pjesësh letrare - pjesë të zgjedhura letrare të botuara ose inedite - përkujtime ngjarjesh tona historike me pjesë të riprodhuara nga revistat dhe fletoret e kohës - statistika mbi aktivitetet shqiptare të ndryshme - njoftime që duheshin ditur etj. Por jeta e Shqipërisë më 29 nëntor 1944 u ndërpre një herë e mirë nga gijotina e E. Hoxhës.

<sup>51</sup> *AQSH*, F. 200, V. 1944, D. 25. Veprimtaria e brendshme e Institutit.

<sup>52</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 25. Shkrimtarë të Shqipnisë: Gjon Buzuku - Meshari; Lekë Matranga - E mbësua më e krështërë; Pjetër Budi - Doktrina e Krishtenë; Fran Bardhi - Georgius Castriottus (për t'u përkthye); Pjetër Bogdani - Çeta e profetve; Jul Variboba - Gjella e Shën Mëris Virgjër, Gjella e Shin Bambinit; Muhamet Çami -

Biblioteka e Botës Shqiptare.<sup>53</sup> Ndër bashkëpunëtorët e Institutit që punuan në mënyrë independente dhe dorëzuan punën e tyre në institucion rezultojnë të kenë qenë: Dom Nikollë Gazulli, i cili hartoi “Toponomastika shqipëtare” (dorëshkrimi i dorëzuar ka qenë 212 faqe dhe në total 10 000 fjalë) dhe “Onomastika shqipëtare” dorëzuar për revistën “Leka”. Të dyja këto punime llogaritet që plotësojnë njëra-tjetrën dhe sipas autorit vetë, “*janë argumenti ma i fortë për me lidhë rracën*”

Erveheja; Grigor Gjinokastriti - Dhjata e Ré; Hjeronym De Rada- Serafina Thopija, Katër Historitë e Shqipnis, Milosao, Skanderbegu i Pafan, Të Ramit e Mbretnis së Shqipnis. Nji pasqyrë e Jetës Njerzore; Anton Santori- Emira; Gabriel Dara - Kënka e Sprasme e Balës; Konstandin Kristoforidhi - Djata e Zotit; Leonard de Martini- Arpa e nji italo-shqiptari; Zef Serembe- Vjersha; Naim Frashëri- Bagëti e Bujqësi, Lulet e Verës, Vjersha, Historija e Skanderbeut, Qerbelaja; Filip Shiroka - Zani i Zembrës; Ndoc Nikaj- Berbuqja, Fejesa në Djep, Lulet në Thes, Shkodra e Rrethueme, pj. I, II; Zef Schiro - Te dheu i huaj, Mili e Hajdhia; Anton Çako- Baba Tomori; Gjergj Fishta - Lahuta e Malcis, Anzat e Parnasit, Mrizi i Zanave, Juda Makabe, Polemikati, Vallja e Parrizit; Mihal Grameno - Oxhaku, Varri i Pagëzimit, E puthura; Aleksandër Drenova - Psallme Murgu; Faik Konica - Proza të zgjedhuna; Kristo Floqi - Triumfi i Liris; Luigj Gurakuqi - Vjersha, Proza; Fan Noli - Historija e Skanderbeut; Ali Asllani - Vjersha; Foqjon Postoli - Për mprojtjen e atdheut, Detyra e memes; Hil Mosi- Vjersha; Vinçenc Prendushi - Vjersha; Lasgush Poradeci - Vjersha; Ernest Koliqi - Vjersha, Proza; Etëhem Haxhiademi - Theatri - Lyra; Kolë Thaçi - Vjersha; Ndre Zadeja - Rozafa; Lazër Shantoja - Proza të Zgjedhuna, Millosh Nikolla - Vjersha, Novela; Nexhat Haku - Vjersha; Sterjo Spasse - Romanca; Vedat Kokona - Novela, Mitrush Kuteli - Rrëfime.

<sup>53</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 25. Biblioteka e Botës Shqiptare: Ky koleksion do të përmbante veprat origjinale, ose përkthimet që merreshin me çështje shqiptare: Histori, Letërsi, Art, Folklor, Ekonomi, Bujqësi, Blegtori dhe gjithë degët e jetës shoqërore të Shqipërisë. Vëllimet që do të përfshiheshin: Histori e Shkurtër e Shqipnis- Letërsia Shqipe- Legjenda Shqiptare- Epopeja e Skënderbeut- Shqiptarët n'Itali- Bujqësia shqiptare - Gjuha Shqipe- Kështjellat e Shqipnis- Shqiptarët e Mëdhenj- Flora e Shqipnis- Fauna e Shqipnis- Kanuni i Lek Dukagjinit- Këngë Popullore të Toskënisë - Këngë Popullore të Gegnisë- Kosova- Shqiptarët në Rumani- Çamëria; Naimi, vjersha të zgjedhuna- Shqiptarët në Turqi- Filoshqiptarët e përmendun - Shqipnia Mineralogjike- Zejtari shqiptare- Fishta: vjersha të zgjedhuna- Tempuj të Shqipnis - Vjersha Patriotike - Kongrese Shqiptare; Çajupi: vjersha të zgjedhuna - Klubet shqiptare- Luftëtarët e Rilindjes- Shqiptarët në Greqi - Historia e Shkollës Shqipe- Gazetaria shqiptare - Bamirës shqiptarë; De Rada: vjersha të zgjedhuna- Lahuta e Malcis shpjeguar popullit - Shqipnia ethnike - Ismail Qemali dhe shpallja e lirisë- Shqiptarët n'Egjypt; Zef Schirò: vjersha të zgjedhuna - Lidhja e Prizrenit - Lojna Shqiptare - Zakone Shqiptare: lindja e fëmisë, fejesa e martesës, vajet; Mjeda: vjersha të zgjedhuna - Bestytini Shqiptare - Proverba shqiptare - Gjeografia Ekonomike e Shqipnis- Masat e përdoruna në Shqipni etj.

*shqiptare me njata popuj që banuenë siujdhazën Ballkanike, sodë dy mijë vjetë*".<sup>54</sup> Zhvillimet e pas vitit 1944 në Shqipëri do t'i vendosin këto punë të vyera në fondin e dorëshkrimeve të shkruara nga autorë të ndaluar për 50 vite me radhë. Me kalimin e kohës, një pjesë e rëndësishme e tyre humbën. Shumë vepra nuk gjenden as në fondet e Akademisë dhe as në ato të AQSH-së. Ndërkohë që Shqipëria e pas vitit 1990 ende nuk ka ndërmarrë një nismë për t'i rinxjerrë në dritë përmes një investigimi, ose për t'i inventarizuar ato që ende ruhen ndër arkivat e lartpërmendur, ose për t'i përfshirë vëllimet e gjetura tanimë, në fondin e edukimit të brezit të ri të Shqipërisë.

Ndryshe nga pushtuesit pararendës italianë, të cilët ndërhyjnë në shumë mënyra në veprimtarinë e institucionit, përmes emërimeve, jo vetëm të profesorëve dhe akademikëve, por edhe të personazheve politike nga Italia në Shqipëri, në Institutin Shqiptar për Studime dhe Arte, gjermanët nuk ishin fare të pranishëm. E vetmja shkresë që gjejmë në dokumentacionin e këtij institucioni në lidhje me komunikimet me autoritetet pushtuese, është një kërkesë-lutje e Gjeneralit të Plotfuqishëm gjerman në Shqipëri, i cili më 2 gusht 1944, i kërkon ndihmë Institutit në fjalë, të organizojë një radhë konferencash për përhapjen e njohurive mbi Shqipërinë për oficerët dhe nëpunësit gjermanë të pranishëm në Tiranë. Në këto konferenca të mbajtura nga lektorët shqiptarë, oficeri i lartë propozon të ftojë si dëgjues edhe anëtarët e legatës gjermane dhe përfaqësues të tjerë të ushtrisë. Synimi zyrtar i kësaj kërkesë kishte të bënte me nevojën që dëgjuesit të kishin një pasqyrë të plotë të zakoneve e jetës shqiptare, dhe për këtë si konferencierë rekomandoheshin përfaqësuesit më profesionistë shqiptarë në fushën e diturisë dhe të arteve. Kërkesa ishte paraprirë nga një konferencë e mbajtur spontanisht dhe privatisht para së njëjtës trupë, prej prof. Ndue Palucës me temë: "Marrëdhëniet kulturore gjermane (austriake)-shqiptare".<sup>55</sup> Shkresës i është përgjigjur më 23 gusht 1944, Kryetari i Institutit, Át Anton Harapi, i cili i shpjegon se në vijim, anëtarët kompetentë të gjuhës gjermane do të njoftoheshin mbi kërkesën e ardhur në adresë

<sup>54</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 31. Letër e meshtarit Nikollë Gazulli, famullitar i Shkrelit, Malësia e Madhe, Shkodër, drejtue Institutit Shqiptar për Studime dhe Arte, Shkrel, 10 gusht 1944.

<sup>55</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 6. Shkresë e Gjeneralit të Plotfuqishëm gjerman në Shqipëri, drejtuar Institutit Shqiptar për Studime e Arte, Tiranë, 2 gusht 1944.

të institucionit që ai drejtonte.<sup>56</sup> Me një shkresë të posaçme ai vendosi në dijeni mbi sa më sipër zotërinjtë: Asllani, Vlora, Çabej, Dosti, Floqi, Gurakuqi, Haxhiademi, Konda, Korça, Lako, Paluca, Poradeci, Samini, Shantoja e Xhuvani.<sup>57</sup> Mirëpo, në arkiv nuk disponohen të dhëna të tjera mbi fatin e këtyre konferencave të propozuara. Duke qenë se ditët e Ushtrisë gjermane ishin drejt fundit, po mendojmë që ato nuk kanë mundur të realizohen.

Në muajin tetor 1944, Këshilli i Administratës së Ministrisë së Arsimit nën kryesinë e zëvendësministrit dr. Rrok Kolaj me anëtarë Henrik Lacaj, Hasan Ceka dhe Luigj Shala, në kushtet e pamundësisë financiare të kësaj ministrie, i dorëzuan Institutit një numër dorëshkrimesh të rëndësishme për t'i shtypur, të cilat kishin rëndësi të veçantë për formimin e nxënësve dhe të rinjve shqiptare. Ndër dorëshkrimet e përpiluara dhe të përgatitura për botim janë: Fjaluer i Vogël nga Jani Llazari; Ligje Arkeologjike, përkthyer nga greqishtja prej Gabriel Meksit, *Raport sur l'astivite de l'Albanie*; Bujqësi elementare - Emin S. Qafa; Histori e Letërsisë Shqipe nga G. Petrotta; *Acta Albaniae* (1407-1451) - Listë librash që flasin për Shqipni; *L'Albanie de 1203 jusqu à là veille du retour de Scanderbeg en Albanie*; Ngritja e Flamurit në Vlorë 1912 - Haki Tahiri; Folklori e Malevet - Kangë të ndryshme; Vargnimi i gjuhës shqipe- Át Zef Valentini; Katalogu i librave të gjuhës shqipe - Át Zef Valentini; Emëra bimësh të mbledhur në Vuno (Himarë) Jani Llazari; Gjuha Shqipe dhe Ilire - përkthyer nga Zef Fekeçi; Biologji e Kombit Shqiptar, Sufflay - Fekeçi; Vjetërsi Shqiptare, gjuhë dhe etnologji, Sufflay - Fekeçi; Historija e Shqipnis - Veniamin Dashi; Mineralogji e Gjeologji në pak njoftuni mbi Gjeografinë e mineralet e Shqipnis - Injac Gj. Ndojaj.<sup>58</sup>

Kështu, puna e anëtarëve të Institutit vijoi deri në ditët kur “gjendja luftarake botnore, përgjithësisht, e për Shqipni veçanisht, po bëhej gjithnjë më e turbulltë. Në vendin t'onë nuk e njef qëni të zo'n: vëllavrasja ka fillue me bā viktímat e veta, njerzit vriten pá mëshirë nëpër rruga, nëpër kafe, nëpër shtëpija e kudo; qeverija nuk ká mē asnji

<sup>56</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 6. Shkresë e Át Anton Harapit, drejtuar Komandës së Naltë Gjermane në Shqipni, Tiranë, 23 gusht 1944.

<sup>57</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 6. Shkresë përcjellëse e Kryetarit Át Anton Harapi drejtuar Misave të Institutit Shqiptar për Studime e Arte, Tiranë, 23 gusht 1944, nr. prot. 139/6.

<sup>58</sup> *Po aty*, F. 200, V. 1944, D. 12. Vendim nr. 132, 4 tetor 1944.

auctoritet; popullsin e ka kapë tmeri; jetesa bâhet përditë mâ e padurueshme, mungojnë mjetet e gjallimit; parja shqiptare shvleftësohet gjithnji; rogat paguhen me shum vonesë. Një hije e zezë i ka rá Tiranës. Ditë të mjerueshme e presin Shqipërinë e shkretë. Jeta e çdonjënit ásht në fije të pënit; ngrihesh në mëngjes pá dijtë se ngrysesh; gjíndja ásht mbyllë mbrenda nga fríga se han ndonji plumb rrugës. Asht e këshillueshme që t'a lâjë përkohësisht Tiranën për të pritë ditë mâ të mira".<sup>59</sup> Kështu mesi i muajit shtator, tetori dhe nëntori i 1944-s, është koha e dezintegritimit tërësor të shtetit, administratës dhe institucioneve civile të vendit, tërheqjes, largimit ose fshehjes nga raprezaljet e të gjithë anëtarëve të Institutit Shqiptar për studime e Arte. Ata morën rrugë të ndryshme. Një pjesë, kush ia arriti të kuptonte dhe e pati mundësinë, u largua nga Shqipëria drejt emigrimit politik. Pjesa që mbeti në Shqipëri priti në dorëzim fatin që do t'i caktonte diktatori i ri, i cili zbriti nga malet e Jugut. Institucioni u dezintegrua dhe puna shkencore e disa brezave, ose u sekuestrua, ose u asgjësua, ose u fshi nga autorësia, u përvetësua nga ekipet e reja që u instaluan në kryeqytet pas 17 nëntorit 1944.

### ROMEO GURAKUQI

Institute of History/ Academy of Albanological Studies, Tirana  
romeo.gurakuqi@asa.edu.al

#### *S u m m a r y*

#### THE ARCHITECTURE OF ALBANIA'S INDEPENDENT SCIENTIFIC INSTITUTIONS DURING 1940-1945

This article deals with the establishment of the Second Academy of Sciences of during the Second World War. One of the most important events in scientific life in Albania after the stabilization of the Italian occupation during 1940, was the establishment of the "Skanderbeg Foundation", consisting of two sections: The Institute of Albanian Studies and the Italo-Albanian "Skanderbeg" Circle. The foundation of this institution can be considered as part of the scientific and cultural "institutional architecture" that the Italians

---

<sup>59</sup> Karl Gurakuqi, *Qi të mos harrohen*, ditari, dorëshkrim, ruhet në arkivin privat të autorit.

created in Albania, in support of their policy of allowing the development of ideal traditional patriotism and encouraging Albanian studies. The Italian assistance to the Albanian researchers and professors in the development of scientific activity for the benefit of their own nation was a camouflage for the other expansionist policies of Fascist Italy in Balkans. But, the people of culture in Albania, used this opportunity to give a further incentive, as they could, without fascist clothing, to the scientific studies, to the education and culture systems in Albania and to the promotion of intellectual life in this very poor country. The scientific works, the research activity and the publication undertaken by this institution has been among the most important and with a very large impact in Albanian science and social life. Thanks to this activity it was possible the standardization of terminology in administration, the programming of student training, the creation of the corpus of documentation for Albanian Foreign Ministry for the expected post-war peace conference, the Vocabulary of Albanian Language etc. During the time of the German occupation, the Institute changed its name, being called the Albanian Institute for Studies and Arts. At the end of 1943 and during 1944, Italian researchers were forced to leave Albania and were deprived from further participation in this scientific institution, giving it a genuine Albanian character and the full contours of the academy of sciences.